



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice



Terre des hommes
Ndihmë për fëmijët.

ANALIZË E QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE

SFIDAT NË ASPEKTIN LIGJOR,
INSTITUCIONAL DHE FUNKSIONAL

publikën e Kosovës 12
në Republikën e Kosovës 12
ornizës ligjore për shërbime sociale në
s të veçantë për QPS-të 30
ërbime sociale në Republikën e Kosovës



TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	5
I.HYRJE	6
Qëllimi i analizës	7
Metodologjia.....	7
II. KONTEKSTI I PUNËS SË QPS-VE DHE HISTORIKU I FUNKSIONIMIT	8
III. ANALIZË E LEGJISLACIONIT DHE TË GJETURAT MBI SFIDAT LIGJORE TË FUSHËS SË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE	10
3.1. Korniza legjislative për shërbime sociale.....	10
3.2. Nevoja për ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore për shërbime sociale me theks të veçantë për QPS-të	20
IV. TË GJETURAT MBI STRUKTURËN DHE FUNKSIONIMIN E QPS-VE	21
4.1 Struktura e Qendrës për Punë Sociale.....	21
4.2 Të gjeturat mbi buxhetin dhe infrastrukturën	26
4.3 Shërbimet e Qendrës për Punë Sociale	31
4.4 Bashkëpunimi dhe Koordinimi.....	33
4.5 Zhvillimi profesional i punonjësve	34
4.6 Sfidat e funksionimit.....	35
V. REKOMANDIMET	37
KOSTIMI I ANALIZËS	40
SHTOJCA 1	44
SHTOJCA 2	45

Ekspertiza për hartimin e analizës është përkrahur nga KOMF, në kuadër të projektit “Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cenueshme në Kosovë”, i mbështetur nga UNICEF në Kosovë në partneritet me USAID Kosovë.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në vitin 2011, është një koalicion i përbërë nga 34 organizata vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët për të avokuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Kosovë.

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF-it apo të USAID.

Prill 2023

Konsulentë:

Prof. Ass. Dr. Blerta Perolli Shehu, [eksperte e çështjeve sociale](#)

Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri, [ekspert ligjor](#)

SHKURTESAT

DKSHMS	Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtje të Fëmijëve
KPSHSF	Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare
LFK	Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës
LMF	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Mbrojtja e Fëmijëve
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Joqeveritare
OK	Organi i Kujdestarisë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
QPS	Qendra për Punë Sociale
TNMR	Tryezat për Ndihmë në Menaxhim të Rasteve
ZSHS	Zyrtar për Shërbime Sociale

I. HYRJJE

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale brenda territorit të tyre, sipas standardeve dhe politikave të Qeverisë apo ministrive përkatëse. Komunat janë të obliguara të identifikojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët e komunës, të planifikojnë shërbimet, të ofrojnë financim dhe të menaxhojnë shërbimet sociale brenda komunës. Drejtoritë Komunale përkatëse për mirëqenie sociale janë përgjegjëse për çështjet komunale të mirëqenies sociale dhe i menaxhojnë edhe Qendrat për Punë Sociale (QPS-të). QPS-të, si akterët kryesorë të mandatuara për koordinimin dhe organizimin e sistemeve të integruara të shërbimeve sociale (në veçanti sistemeve për mbrojtje të fëmijëve), kanë përgjegjësi për të ofruar shërbime sociale dhe familjare për qytetarët në nevojë. Të gjitha komunat në Kosovë (38) kanë Qendra për Punë Sociale.

Të dhënat nga raporti i monitorimit të KOMF (2021) se, përkundër mandatit të komunave dhe QPS-ve për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale, kapacitetet e komunave për të ofruar shërbime sociale cilësore vazhdojnë të jenë të kufizuara. QPS-të po përballen me vështirësi serioze, sidomos në aspektin ligjor dhe funksional. Raporti i monitorimit nga KOMF si dhe raporte të tjera nga organizatat e ndryshme që janë realizuar në 4 vitet e fundit kanë nxjerrë në pah se megjithëse ekziston një bazë e infrastrukturës ligjore, dy projekt-ligjet kryesore (Projektligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal) duhet të prioritetizohen si për qartësimin e kompetencave dhe përgjegjësisë të nivelit qendror dhe lokal dhe avancimin e shërbimeve sociale, ashtu edhe për rregullimin e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Për më tepër, është identifikuar edhe nevoja për përmirësimin dhe harmonizimin e akteve nënligjore dhe fuqizimin e zbatueshmërisë së tyre. Studimet dhe analizat e kryera në vitet e fundit nxjerrin në pah edhe sfida strukturore dhe funksionale si infrastruktura e vjetëruar, mungesa e stafit, mungesa e shërbimeve, profilizimi profesional i stafit dhe shërbimeve, planifikimi dhe koordinimi i fragmentuar si dhe financimi i paqëndrueshëm. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është edhe qëndrueshmëria e kufizuar financiare e organizatave joqeveritare (OJQ) që ofrojnë shërbime sociale në Kosovë. Komunat dhe niveli qendror nuk ofrojnë përkrahje të qëndrueshme për kontraktimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore nga sektori joqeveritar. Përkundër një vendimi nga Ministria e atëhershme Punës dhe Mirëqenies Sociale për hartimin e formulës së financimit për shërbime sociale, formulë kjo mbi të cilën do të bazohej shumica e buxhetit të ndarë në kuadër të Grantit Specifik për Shërbime Sociale, ende nuk është arritur të finalizohet formula e financimit për shërbime sociale. Pritet që me aprovimin e Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, do të punohet edhe në hartimin e një Udhëzimi Administrativ që do të rregullonte funksionimin dhe shpërndarjen e Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

Qëllimi i analizës

Qëllimi i kësaj analize është të identifikojë sfidat kryesore të Qendrave për Punë Sociale, në aspektin ligjor, institucional dhe funksional dhe të prezantojë boshllëqet dhe zgjidhjet përkatëse për një ristrukturim të duhur të këtyre organeve në kuadër të procesit të reformës së plotë të shërbimeve sociale në Kosovë. Që nga Janari 2023, përgjegjësitë për hartimin e politikave, standardeve dhe inspektimin e shërbimeve sociale janë transferuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në Ministrinë e Drejtësisë (MD). Për të zbatuar në mënyrën më të mirë të mundshme reformën e shërbimeve sociale dhe për të adresuar nevojat e qytetarëve, kjo analizë do të shërbejë si bazë për reformimin e QPS-ve në aspektin ligjor, institucional dhe funksional.

Metodologjia

Metodologjia që është zbatuar përgjatë kësaj analize paraqet një qasje të kombinuar të hulumtimit sasior dhe cilësor me qëllim të mbledhjes së të dhënave mbi funksionimin aktual strukturor të QPS-ve, sfidat me të cilat ballafaqohen në aspektin e rregullimit ligjor apo të realizimit në praktikë të detyrimeve që kanë dhe mbledhja e mendimeve të profesionistëve të fushës lidhur me rrugën që duhet të marrë reforma e shërbimeve sociale. Analiza është mbështetur në mbledhjen e të dhënave nga dy burime kryesore:

- (i) **Burimet parësore** – QPS-të dhe OJQ-të - Është dizajnuar një instrument sasior/cilësor për mbledhjen e të dhënave në formë të intervistave të gjysmë-strukturuara për QPS-të. Intervista ka përmbajtur gjithsej 4 seksione (pyetjet mbi kapacitetet dhe strukturimin aktual të QPS-ve, pyetjet mbi funksionimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e stafit, pyetjet mbi sfidat strukturore, funksionale dhe ligjore dhe pyetje mbi sugjerimet dhe rekomandimet). Instrumenti është shpërndarë tek të gjitha QPS-të, dhe QPS-të nga gjithsej 28 komuna (prej 38) i janë përgjigjur intervistës. Lista e QPS-ve mund të gjendet në Shtojcën 1. Është dizajnuar edhe një protokol interviste për mbledhjen e të dhënave nga përfaqësues të OJQ-ve që ofrojnë shërbime në partneritet me QPS-të. Gjithsej 5 OJQ janë intervistuar.
- (ii) **Burimet dytësore** - burimet dytësore kanë përfshirë kornizën ligjore aktuale, si dhe dokumentet, analizat dhe raportet e institucioneve të ndryshme nga pesë vitet e fundit, e që kanë patur për bazë studimin e sfidave të QPS-ve. Pra, burimet dytësore kanë përfshirë edhe raportet relevante dhe studimet empirike të kryera më herët nga organizatatat kredibile mbi gjendjen dhe kapacitetet e qendrave për punë sociale në Kosovë.

Pas analizës së të dhënave, janë përpunuar të gjeturat dhe është hartuar raporti, i cili është diskutuar me grupin punues i themeluar për zhvillim të analizës në një punëtori dy ditore dhe është plotësuar tutje pas inpueteve nga anëtarët e grupit punues. Versioni i fundit është validuar nga grupi punues.

II. KONTEKSTI I PUNËS SË QPS-ve DHE HISTORIKU I FUNKSIONIMIT

Në territorin e Kosovës janë 38 Qendra për Punë Sociale në 38 komuna me rreth 400 zyrtarë të shërbimeve sociale dhe zyrtarë të mirëqenies sociale. Sipas raporteve statistikore të DPSF (2021), numri i të punësuarve në QPS është 404, në shërbimin social janë evidentuar 164 zyrtarë të shërbimeve sociale, të cilët janë profesionist të shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushë të sociologjisë, drejtësisë, punës sociale, psikologjisë, pedagogjisë ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe regjistruar në regjistër të Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.

QPS-të janë organet kryesore të autoriteteve komunale të mandatuara për të ofruar kujdes social, mbrojtje sociale dhe shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë, si dhe për të koordinuar dhe organizuar një sistem të integruar të shërbimeve sociale dhe familjare brenda secilës komunë. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmës materiale për njerëzit në nevojë sociale. Shërbimet sociale në Kosovë rregullohen me Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare u miratua në vitin 2005, duke vendosur kështu bazën ligjore për rregullimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë. Me këtë ligj u përcaktuan rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë së atëhershme të Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Komunës, QPS-së dhe shoqërisë civile. Në vitin 2006, u themelua edhe Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe filloi trajnimi i kuadrit të ri të punëtorëve social për QPS-të dhe për OJQ-të, duke lansuar kështu një përpjekje domethënëse për të futur në përdorim një sistem të integruar të mbrojtjes sociale, për riparime infrastrukturore, ndërtim të QPS-ve si dhe për trajnim të personelit. Nga viti 2007, filloi edhe elaborimi i një sistemi më holistik të mbrojtjes sociale, me një strukturë paksa më të qartë administrative adekuate, që garantonte të drejta të caktuara për grupet e marxhinalizuara, duke mundësuar decentralizimin e sistemit, dhe ndërtimin e shërbimeve sociale bazuar në komunitet. Buxheti për shërbimet sociale dhe për QPS-të ishte shumë i ulët dhe dominohej nga buxheti për përkujdesje institucionale rezidenciale, duke sugjeruar se shërbimet sociale me bazë komunitare që ofroheshin nga qeveria qendrore praktikisht ishin inekzistente. Në kontekstin e politikës së Qeverisë për decentralizimin të iniciuar në vitin 2008, sektori i shërbimeve sociale në Kosovë u përballë me ndryshime dramatike. Decentralizimi i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale 2008, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal të vitit 2008, dhe një Memorandum Mirëkuptimi të vitit 2009, i bënte komunat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve sociale, dhe për menaxhimin e QPS-ve. Nën këtë marrëveshje, shërbimet sociale ishin nën

kompetencën e komunave nën menaxhimin e Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Megjithatë në praktikë, nuk u transferuan të gjitha kompetencat, duke përfshirë edhe shërbimet e veçanta të ofruara për fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, mandati për monitorimin dhe inspektimin mbeti në kompetencë të nivelit qendror. Bartja e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal nuk është përcjellë me financa, formulë financimi dhe formulë kostimi të shërbimeve.

Sot, shërbimet sociale dhe familjare janë në një fazë të rëndësishme të zhvillimit, ku theksi vihet në përmirësimin dhe cilësinë e shërbimeve dhe financimin e qëndrueshëm të tyre. Rëndësia e të siguruarit, përmirësimit dhe monitorimit të cilësisë së shërbimeve sociale që janë transferuar në menaxhimin komunal është thelbësore. Përfituesit e shërbimeve sociale janë njerëz me cenueshmëri të veçantë, të cilët varen prej këtyre shërbimeve dhe shpesh nuk kanë burim tjetër të mbështetjes dhe mbrojtjes. Autoriteti kryesor sot për sigurimin e mbrojtjes sociale dhe mirëqenies së qytetarëve të tyre bie mbi Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe pamundësia e këtyre drejtorive për të siguruar cilësinë e domosdoshme të shërbimeve ndikon drejtpërdrejtë në mirëqenien e përfituesve të shërbimeve sociale sot.

Ligjet aktuale, kërkojnë që QPS-të të kenë kapacitete të fuqishme profesionale dhe organizative për të marrë përsipër përgjegjësinë që iu është dhënë atyre në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijëve dhe familjeve. Megjithatë, QPS-të as sot nuk kanë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të vlerësuar gjendjen e të gjithë fëmijëve dhe familjeve në komunat e tyre dhe për të ndërhyrë me shërbime të nevojshme, ndaj edhe shërbimet e tyre nuk i arrijnë të gjitha familjet në nevojë. Në mungesë të burimeve dhe përkrahjes, QPS-të mbingarkohen me reagim në raste emergjente, duke lënë mënjanë shërbimet parandaluese, shërbimet përcjellëse dhe arritjen/ruajtjen e cilësisë të ofrimit të shërbimit. Kjo vjen si pasojë jo vetëm e numrit të pamjaftueshëm të punonjësve në QPS krahas rasteve në nevojë, por edhe si pasojë e mungesës së buxhetit, infrastrukturës së pamjaftueshme, dhe mungesës së profilizimit profesional brenda QPS-ve. Raportet e monitorimit nga KOMF në vitin 2021 theksojnë se edhe sot për shkak të kufizimeve në burime njerëzore dhe financiare, shërbimet sociale janë të fokusuar në ofrimin e shërbimeve emergjente të mbrojtjes dhe ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe re-integrimit, të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien e fëmijëve dhe personave në nevojë. Raporti i Monitorimit të KOMF tregon që edhe gjatë vitit 2021, QPS-të kanë vazhduar të kenë qasje reaktive sa i përket matjes së cenueshmërisë në komunat ku veprojnë. Asnjë QPS në komunat e monitoruara, nuk ka pasur mundësi dhe kapacitet që të dalë në terren dhe të bëjë vlerësimin e qytetarëve në nevojë.

Raportet e monitorimit nga KOMF theksojnë se QPS-të nuk kanë pasur financim të veçantë nga komunat të dedikuar vetëm për shërbime sociale. Komunat kryesisht kanë mbuluar pagat mujore dhe shpenzimet administrative për QPS-të, duke mos ndarë buxhet për QPS-të, për ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në nevojat e qytetarëve brenda komunave. Në të gjitha komunat, buxheti aktual nuk plotëson as për së afërmi nevojat reale për shërbime sociale, kjo edhe për faktin se mungon planifikimi i bazuar në nevoja. Financimi i paqëndrueshëm i shërbimeve sociale dhe familjare e vështirëson përfundimin e procesit të decentralizimit dhe adresimin e sfidave me të cilat edhe sot ballafaqohet sistemi i shërbimeve sociale dhe familjare.

III. ANALIZË E LEGJISLACIONIT DHE TË GJETURAT MBI SFIDAT LIGJORE TË FUSHËS SË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

3.1. Korniza legislative për shërbime sociale

Sistemi i mbrojtjes sociale, pas Kushtetutës bazohet edhe në Konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, disa prej të cilave janë të numëruara taksativisht në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, zbatohen drejtpërdrejtë në Kosovë dhe kanë epërsi mbi ligjet. Për sa i takon Konventave dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare që nuk janë të zbatuara drejtpërdrejtë në Kosovë, me rastin e hartimit të ligjeve, legjislacioni i Kosovës gjithmonë hartohet në pajtim me parimet e përgjithshme të tyre, për aq sa ka mundësi që ato të gjejnë zbatim në Kosovë. Disa nga Konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, si dhe disa nga ligjet më të rëndësishme që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë fushën e shërbimeve sociale janë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Karta Evropiane Sociale;
- Korniza Evropiane Vullnetare e Cilësisë për Shërbimet Sociale;
- Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijës;
- Ligji i Familjes (Ligji Nr.2004/32);
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (Nr. 02/L-17); Ligji (Nr. 04/L-081) për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, dhe Ligji Nr. 04/L-081;
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040);
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji Nr. 03/L-049);
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr. 06/L-084);
- Ligji për Ndërmarrjet Sociale, (Ligji Nr. 06/L-022);
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048) (2008, i plotësuar dhe ndryshuar);
- Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale, (Ligji Nr. 2003/15);
- Ligji për Mbeshtetjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, (Ligji Nr. 03/L-22);
- Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-042), si dhe Ligjin Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237;
- Direktiva 2014/24/EU për prokurimin publik dhe shfuqizimi i Direktivës 2004/18/EC¹.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - e definon Kosovën si shtet i cili “bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, të drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe të ekonomisë së tregut (neni 7). Gjithashtu, me Kushtetutë parashihet zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtave dhe lirive të parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolet e saj, dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (neni 22). Më tepër kujdes i është kushtuar barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi, se sa çështjeve të drejtësisë sociale dhe shtetit të mirëqenies. Në nenin 50 janë paraqitur të drejtat e fëmijës, ndërkaq, neni 51 i Kushtetutës vetëm thekson se kujdesi shëndetësor dhe *sigurimi social* rregullohen me ligj, dhe se sigurimi social themelor që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë rregullohet me ligj. Në të vërtetë, në Kosovë sistemi legjitimohet me vlerat tipike liberale, për dallim nga rajoni, që edhe më tej kultivon traditat evropiane të social-demokracisë. Kur

¹ Duke vlerësuar edhe analizat tjera të bëra deri më tani dhe raportet e ndryshme vlerësuese lidhur me fushën e shërbimeve sociale dhe familjare në përgjithësi dhe QPS-ve në veçanti, kjo analizë e radhës tenton të mos përsëriten raportet dhe analizat paraprake, por të tentohet për aq sa është e mundur të thuhet diçka përtej atyre. Gjithashtu për shkak të kufizimeve kohore, në këtë analizë do të trajtohen vetëm disa nga konventat dhe instrumentet ndërkombëtare dhe disa nga ligjet më të rëndësishme për fokusin e interesit të kësaj analize. Aktet nënligjore nuk do trajtohen për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion.

kemi të bëjmë me organizatat joqeveritare dhe me iniciativat qytetare, neni 44 i Kushtetutës garanton lirinë e asociimit, e cila ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Çështja e themelimit dhe punës së organizatave joqeveritare detajisht është rregulluar me Ligjin për lirinë e bashkimit në organizatat joqeveritare (Ligji nr. 04/L-057), ku edhe në fushën e shërbimeve sociale organizatat joqeveritare kanë rol dhe rëndësi jashtëzakonisht të madhe në ofrimin e shërbimeve sociale.

Ligji për Familjen i Kosovës është ligji bazik për fushën e të drejtës familjare, i cili përmban edhe dispozita materialo-juridike, por edhe dispozita proceduralo-juridike, duke i përcaktuar kompetenca dhe përgjegjësi më shumë se të gjitha ligjet tjera për Organin e Kujdestarisë (Qendrën komunale për Punë Sociale, siç e njeh LFK). Nga kjo shihet që Ligji për Familjen e identifikon Organin e Kujdestarisë me QPS-në dhe ka shumë dispozita lidhur me organin e kujdestarisë, ku përcaktohet se:

“Neni 6 - Mbrojta Institucionale e të drejtave”

(1) Punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t’i ushtron organi kompetent i administratës komunale, i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale.

(2) Organi i Kujdestarisë është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale. Ai përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësive.

(3) Organi i Kujdestarisë mundet gjithashtu të jetë organ (grup i ekspertëve siç është cekur më lart) i veçantë i institucionit social i themeluar nga Kuvendi Komunal për të kryer detyrat e tilla.

(4) Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrorë mjetet juridike dhe të ndër marrë veprime të tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t’i dorëzojë atij të gjitha vendimet”.

Duke patur parasysh rëndësinë e madhe që ka Organi i Kujdestarisë brenda QPS-së edhe [Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe ligjet e tjera materialo-juridike, përcaktojnë shumë detyrime për Organin e Kujdestarisë, e të cilat janë të njohura për secilin profesionist të shërbimeve sociale, andaj nuk do të trajtohen më shumë](#). Ajo që vlen të përmendet është edhe fakti se përveç ligjeve materialo-juridike, rëndësi të jashtëzakonshme Organit të Kujdestarisë i kushtohet gjithashtu edhe me ligjet procedurale, si: Ligji për Procedurën Jokontestimore², Ligji për Procedurën Kontestimore³ dhe ligjet tjera që rregullojnë çështje të caktuara ku janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e Organit të Kujdestarisë⁴.

² LPJ përmban Nenet që rregullojnë fusha të ndryshme me dispozita të veçanta lidhur me detyrimet e Organit të Kujdestarisë, si: Neni 4, 6, 7, 15, 29, 32, 34, 37, 39, 41, 52, 54, 55, 56, 61, 62, 66, 68, 70, 72, 73, 88, 92, 93, 95, 99, 101, 103, 105, 108, 109, 110, 111, 118, 121, 146, 152, 156, 157, 161.

³ LPK përmban Nenet që rregullojnë fusha të ndryshme me dispozita të veçanta lidhur me detyrimet e Organit të Kujdestarisë, si: Neni 67, 77, 78, 79, 80, 82, 343, 346.

⁴ Lidhur me problemet në funksionalizimin e Organit të Kujdestarisë dhe nevojën e ndërhyrjes legislative do të trajtohet në pjesët më poshtë të kësaj analize.

Megjithatë, nga zyrtarët e shërbimeve sociale është theksuar se kanë problem të kuptojnë saktë mos konsistencën e terminologjisë ligjore përsa i takon Organit të Kujdestarisë, andaj rekomandohet që në plotësim ndryshimet e ardhshme të ligjeve përkatëse të ketë një unifikim të terminologjisë dhe përkufizimit të Organit të Kujdestarisë, për të shmangur konfuzionet eventuale tek zbatuesit.

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare - Në nenin 1 paragrafi 1.3 të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare parashihet se: “Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit apo në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale”. Kjo do të thotë se përkujdesja sociale është veprimtari me interes të veçantë për Republikën e Kosovës me të cilën sigurohet dhe realizohet ndihma për të plotësuar nevojat themelore jetësore për personat në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen, ndërsa përkujdesja mund të ofrohet në shtëpinë e vetë personit, në një familje tjetër, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor apo në një institucion rezidencial. Gjithashtu, në vetë fillimin, Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare përparësi eksplicite u jep shërbimeve në bashkësi në raport me shërbimet e vendosjes në institucione.

Përfituesit e mbrojtjes sociale definoohen si persona në gjendje nevojë. Në këtë grup bien personat të cilët kanë nevojë për shërbime sociale nga këto arsye: fëmijë pa përkujdesje prindërore; fëmijë me sjellje asociale; delikuent i mitur; marrëdhënie të çrregulluara në familje; moshë e shtyrë; sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike; aftësi të kufizuara mendore; sëmundje mendore; rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi; dhunë në familje; trafikim të qenieve njerëzore; varësi nga alkooli ose drogat; emergjenca ose fatkeqësi të shkaktuara nga natyra apo njeriu; ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë (neni 1). Me nenin e njëjtë është përkufizuar edhe familja në nevojë *“ku njërit ose të dy prindërve ose kujdestarit tjetër u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijë për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës ose në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore ose abuzimit nga ana e prindit ose prindërve të tij ose për shkak të paaftësisë së prindit apo prindërve ose kujdestarit të tij që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë.”*

Sa i përket të drejtave të përfituesve, LSHSF nuk specifikon të drejta sociale të veçanta ose të drejta në shërbime, siç i definojnë legjislacionet e shteteve në rajon, por thekson të drejtën në vlerësim. Kështu në nenin 1, pika 1.4 rregullohet se *“çdo person ose familje që e konsideron veten të jetë në nevojë sipas dispozitave të këtij ligji ka të drejtë që t’i vlerësohen rrethanat nga qendra për punë sociale e vendit ku jeton, ose në të cilin gjendet, dhe t’i plotësohen këto nevoja nëse është e arsyeshme që qendra për punë sociale të veprojë kësisoj, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë shkallën e nevojës dhe ekzistimin e burimeve për përmbushjen e saj”*. Mirëpo, LSHSF në mënyrë të hollësishme merret me çështjen e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të fëmijës, edhe pse pjesa për shërbimet për personat e rritur është mjaft e shkurtër.

Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Neni 6, paragrafi 6.6 specifikohet që *“Çdo drejtorat siguron që qendra për punë sociale në territorin e vet të ketë resurse sipas standardeve të specifikuara nga Ministria. Kjo përfshin llojin dhe numrin e personelit profesional që duhet punësuar. Vlen të përmendet që deri më tani Ministria nuk ka specifikuar standard për përbërjen dhe numrin e stafit profesional multi-disiplinar në kuadër të shërbimit social të QPS.*

Sa i përket ndarjes së kompetencave në mes të nivelit qendror dhe komunal, LSHSF nuk e bënë një ndarje të qartë të drejtave dhe përgjegjësi në mes të dy niveleve. Për pasojë, përfaqësuesit nga QPS dhe komunat deklarojnë se ende ekzistojnë paqartësi në ndarjen e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi në mes të dy niveleve atij qendror dhe komunal. Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të rregullojë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë për ministrinë, komunat dhe Qendrat për Punë Sociale.

LSHSF është kryesisht i orientuar drejt shërbimeve për mbrojtjen e qytetarëve (me fokus fëmijëve) në nevojë për shërbime sociale, duke lënë anash shërbimet e parandalimit dhe reintegrimit. Aktualisht shërbimet sociale janë të fokusuara në ofrimin e shërbimeve emergjente, të mbrojtjes, dhe ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe reintegrimit, të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien e fëmijëve dhe personave në nevojë për shërbime sociale. Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të fuqizojë komponentën e parandalimit, rehabilitimit dhe reintegrimit, tu dalë në ndihmë qytetarëve, të parandalojë abuzimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe të ofrojë mbështetje për rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre. Për më tepër, planifikimi dhe ofrimi i shërbimeve për parandalim, ul koston financiare shtetërore për mbrojtje dhe shërbime sociale si dhe ul shkallën e riviktimizimit apo recidivizmit.

Edhe Kosova sikurse shtetet në Europë, ka ndjekur politikën e zhvillimit të partneritetit në mes të QPS-ve dhe organizatave jo-qeveritare të cilat ofrojnë shërbime, duke vendosur kështu një skemë të hapur të ofrimit të shërbimeve sociale nga ofruesit publik dhe jo qeveritar. Megjithatë kjo politikë duhet fuqizuar në kuadër të Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare. *Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të përcaktojë organizimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe të fuqizojë një skemë të hapur të ofrimit të shërbimeve në mes të ofruesve publik, joqeveritar dhe privat.* Ligji i ri, duhet të përcaktojë shërbimet sociale të cilat duhet të ofrohen vetëm nga Qendrat për Punë Sociale, pra të cilat nuk mund të kontraktohen, shërbimet sociale të cilat mund të ofrohen në bashkëpunim me organizatat jo qeveritare dhe private si dhe shërbimet sociale që mund të kontraktohen nga sektori joqeveritar dhe privat.

Sa i përket llogaridhënies së ofruesve të shërbimeve sociale, përfshirë QPS-të, LSHSF në Nenin 3, paragrafi 3.4 përcakton që departamenti, në emër të ministrisë, zhvillon inspektime të shërbimeve sociale, në institucionet e përcaktuara me ligj si dhe në organizatat joqeveritare dhe në sektorin privat. Ndërsa në paragrafin 3.5 përcakton që për çdo inspektim departamenti përpilon një raport i cili vë në pah arritjet dhe mangësitë, duke ofruar këshilla dhe udhëzime sipas nevojës. Në formën siç është e përkufizuar, mangësia qëndron në atë se LSHSF nuk ka përcaktuar kompetenca ekzekutive për Njësinë e inspektimit por i ka dhënë funksion këshilldhënës. *Propozohet që Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare të përcaktojë kompetencat ekspektive për Njësinë e inspektimit, të parashikojë masat, gjokat dhe sanksionet në rast të shkeljes së dispozitave ligjore të këtij ligji.* Rekomandohet që të ardhurat nga gjokat dhe sanksionet të dedikohen për shërbime sociale.

Vlen poashtu të përmendet që LSHSF nuk parasheh licencimin e shërbimeve sociale të ofruara nga QPS-të apo institucionet e tjera publike. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve sociale në QPS propozohet që Ligji i ri për Shërbime Sociale të parashikojë: Licencimin e shërbimeve publike të ofruara nga QPS dhe institucionet tjera publike ofruese të shërbimeve sociale.

Në Ligjin e ri për Shërbime Sociale duhet të parashihet poashtu hartimi i një akti nënligjor që e rregullon strukturën dhe organogramin e QPS-së.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale – përcakton se përkujdesja sociale është radhitur në rrethin e punëve të vetëqeverisjes lokale. Në të vërtetë në nenin 17 paragrafi 1 nën paragrafi k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale është përcaktuar se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, edhe në fushën e ofrimit të shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cënueshmit, strehimi familjar, përkujdesi fëmijëror, përkujdesi për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale. Do të thotë se edhe me ligjin në fjalë, është vazhduar me decentralizimin e shërbimeve sociale dhe familjare duke i përcaktuar si kompetenca vetanake të komunave si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale. Mirëpo, nëse kemi parasysh dispozitën e nenit 2 paragrafi 2.3 të *Ligjit bazik për Shërbimet Sociale dhe Familjare, me të cilën është përcaktuar se komunat apo organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë edhe ndërmarrjet private mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, por që, Ministria rezervon të drejtën që të përcaktojë ku, si dhe kush i kryen këto shërbime, ndërsa Ligji për vetëqeverisjen lokale, gjithashtu si ligj bazik, ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare i konsideron si kompetenca vetanake, përkatësisht si kompetenca të plota dhe ekskluzive të komunës (Neni 17 paragrafi 1 nën paragrafi k)*, gjë e cila flet mjaft se janë në kundërshtim me njëra tjetrën, dhe se nuk është e qartë kryerja e shërbimeve sociale dhe familjare në fjalë. Këtu shihet kolizioni i këtyre dispozitave ligjore.

Gjithashtu, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, krahas kompetencës vetanake të theksuar të komunave në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, në dispozitën e nenit 18 mbi kompetencën e deleguar, ka paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore që në pajtim me ligjin, komunave tu delegojnë përgjegjësi edhe nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare lidhur me distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve) (neni 18 paragrafi 18.1 nën paragrafi e). Mirëpo, sipas paragrafit 18.2 të nenit 18, Ligji në fjalë, autoriteteve qendrore ua len mundësinë që komunave, po që se është e nevojshme dhe në pajtim me ligjin, t'u delegojnë kompetenca shtesë. Vlen të theksohet se në këtë ligj, ekziston dispozita, e cila ka paraparë se kompetencat e deleguara, në të gjitha rastet, duhet të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria (Paragrafi 18.3 i nenit 18 të ligjit për vetëqeverisjen lokale).

Në dokumentet evropiane për të drejtat sociale, sikurse edhe në interpretimin e tyre, bëhet me dije për nevojën e decentralizimit të shërbimeve sociale. Në nenin 4 paragrafi 3 të Dokumentit Evropian për Vetëqeverisjen Lokale qëndron se Autorizimet publike do të kryhen ashtu që preferohet t'u takojnë pushteteve të cilët janë afër qytetarëve. Andaj, mund të konkludohet se decentralizimi është nevojë e supozimit të realizimit të procesit largpamës të ndryshimit të rolit të shtetit në sferën sociale, e në këtë dhe të decentralizimit të shërbimeve sociale. Në të vërtetë, bëhet fjalë për elementet qenësore të konceptit të politikës sociale të kombinuar, që e zhvillojnë edhe shtetet në rajon (Kroaci, Slloveni, etj.).

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal - Shërbimet sociale janë kompetencë vetanake komunale dhe bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal ato financohen nga komunat përmes dy burimeve të financimit që janë granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale. Granti i përgjithshëm është grant i tipit të mbyllur me 10% të të hyrave të projektuara që do të duhen të mblidhen në nivel qendror gjatë një viti kalendarik. Mirëpo problemi për shërbime sociale fillon pikërisht këtu, sepse kjo formë nuk ofron garanci që do të ketë ndarje të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale. Kjo sepse nga këtu nuk ka ndonjë mekanizëm apo formulë financimi të ndarjes për shërbimet sociale, duke ditur se nga këto shuma buxhetojnë të gjitha departamentet për shpenzimet operative dhe kapitale. Në pamundësi që të sigurohet një mekanizëm i qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale çështja është shndërruar në problem kritik ekzistencial për mbarëvajtjen e QPS-ve dhe organizatave jo-qeveritare ofruese të shërbimeve sociale.

Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në mëshirë të vullnetit të nivelit komunal (duke pasur parasysh financimin e pamjaftueshëm në vitet e fundit), është sugjeruar të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit brenda Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, përmes krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Ky grant duhet të jetë krahas granteve për arsim dhe shëndetësi si grant specifik për shërbime sociale. Granti Specifik për Shërbime Sociale do të duhet të përmbajë kriteret e qarta në mënyrë që të sigurojë ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale.

Formula e financimit për Shërbime Sociale – në Kosovë akoma nuk është nxjerrë formula e financimit për shërbime sociale e si pasojë nuk ka kosto për njësi për secilin shërbim të ofruar. Kjo pamundëson planifikimin dhe ndarjen buxhetore bazuar në nevojat e klientëve për shërbime sociale.

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës – përveç dispozitave tjera me të cilat avancohet mbrojtja e të drejtave të fëmijës, përcakton detyrimin për themelimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve me vet dispozitën e nenit 30 par. 1 ku përcaktohet se: *“Me këtë ligj themelohen shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve, nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale pranë Qendrave për Punë Sociale përkatëse ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore”*. Nga kjo dispozitë ligjore shihet se vet ligji në fjalë ka themeluar shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe jo rastësisht ligjdhënësi përdorë shumësin pasi që duhet të themelohen disa shtëpi për mbrojtjen e fëmijëve të kategorive të ndryshme. Këto shtëpi themelohen në të gjitha regionet e Kosovës ku ka Gjykata dhe Prokurori (7 regjione), pranë QPS-ve.

Natyrisht se nevojitet ndryshimi dhe plotësimi i pjesës së Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e brendshëm të Komunave, ku do të shtohen edhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve si pjesë e strukturës së tyre organizative.

Sipas nenit 30 paragrafi 2, organ kompetent për përcaktimin e standardeve dhe miratimit të themelimit të shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve është Ministria përkatëse e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ligji do duhej të ishte më i qartë dhe më konciz në këtë aspekt, por natyrisht detyrë e jona nuk është të japim vërejtje në këto dy dispozita ligjore të cilat ndoshta do duhej të ishin shkruar ndryshe, pasi që do duhej ndarë kompetencat e nivelit lokal dhe qendror gjë e cila për dikë që nuk e njeh mirë sistemin juridik dhe aspektet legislative se cila dispozitë e derogon tjetrën e ka shumë problem për të kuptuar.

Nëse parimi i decentralizimit me të vërtetë dëshirohet të zbatohet praktikisht në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet shqyrtuar dhe vendosur kornizën ligjore me të cilën vetëqeverisja lokale ka kompetenca të definuara në mënyrë të qartë në këtë fushë.

Rregullorja për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive - Në favor të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare duhet të përkujtohen edhe dispozitat organizativo-funksionale të ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të përmbajtura në aktin juridik, përkatësisht në Rregulloren (QRK) – Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e cila është miratuar në mbledhjen e 3-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 01/03, datë 06.06.2020. Në Shtojcën 12 të kësaj rregulloreje, ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (pastaj kalimi në MFPT dhe tani në MD) ka shumë përgjegjësi edhe nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare, të cilat shkojnë edhe në favor të decentralizimit dhe delegimit të shërbimeve sociale dhe familjare. Në të vërtetë pas shuarjes së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale fusha e Shërbimeve Sociale ishte bartur në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe tani së fundi pjesa e Departamentit të Shërbimeve Sociale dhe Familjare ka kaluar faktikisht në Ministrinë e Drejtësisë, por që kjo duhet të bëhet edhe duke specifikuar këtë në Rregulloren për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, Rregullorja në fjalë duhet të adresoj kompetencat në Ministrinë e drejtësisë, ndërsa një pjesë e kompetencave të mbrojtjes sociale kanë mbet në kompetencë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Korniza ligjore në Kosovë që rregullon kontraktimin/komisionimin e shërbimeve sociale - Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare siç është plotësuar dhe ndryshuar krijon bazën kryesore juridike jo vetëm për ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, por edhe për kontraktim të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur organet shtetërore që janë përgjegjëse për ofrimin e këtyre shërbimeve, nuk kanë mundësi dhe kapacitete të brendshme për ofrimin e tyre. Ky Ligj përcakton decidivisht mundësinë e kontraktimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga OJQ-të. Bazuar në nenin 8, paragrafi 4, krijohet mundësia që edhe komunat të lidhin kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve sociale brenda territorit të tyre, sipas nevojave dhe planifikimeve të tyre. Gjithashtu neni 8, paragrafi 5 i Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare përcakton kompetencën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministrisë së Drejtësisë për kompetencat e bartura, e cila autorizohet me ligj që të japë fonde dhe të ofrojë çfarëdo ndihme tjetër materiale, për organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të veçanta

sociale dhe familjare në nivel të Kosovës, përmes procedurave të komisionimit dhe kontraktimit. Këtu shihet se është bërë një lëvizje ligjore në drejtim të rregullimit të veçantë të fushës së shërbimeve sociale dhe lejimin e kontraktimit të tyre, por qëndron problemi se nuk gjenden dispozita ligjore procedurale, gjë e cila e pamundëson zbatimin e tyre ndaras nga prokurimet e tjera, andaj paraqiten pengesa evidente dhe pa ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik dhe krijimin e mirëfilltë të bazës juridike, për rregullimin e fushës së komisionimit dhe kontraktimit të shërbimeve.

Në linjën e njëjtë të tentativave për hapjen e mundësive për kontraktimin e OJQ-ve për ofrim të shërbimeve sociale është edhe tentativa e bërë me ligjin Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237**, me të cilin organizatave të shoqërisë civile u është mundësuar që të konsiderohen **operator ekonomik** për qëllim të ligjit të Prokurimit Publik, e që është një hap shumë i rëndësishëm në zhvillimin e këtij sektori, pasi që OJQ-të mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik krahas subjekteve tjera juridike dhe ekonomike, meqenëse kanë marrë statusin e operatorit ekonomik.

Gjithashtu, po kaq i rëndësishëm është edhe Neni 132/A “Kontraktimi i shërbimeve nga OSHC”, dispozitë kjo e cila është shtuar në ligjin për Prokurim Publik që nga viti 2016, i cili përcakton se: *Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile*. Kjo dispozitë krijon bazën ligjore për Qeverinë për rregullimin e procedurave të prokurimit për OJQ-të që kanë të bëjnë me kontraktimin e shërbimeve në përgjithësi, por që ky akt nënligjor nuk është nxjerrë dhe rrjedhimisht kjo dispozitë ligjore ka mbetur jo funksionale, pasi që nevojitet zbritimi i saj përmes aktit nënligjor të Qeverisë për rregullimin e procedurave specifike vetëm për kontraktimin e shërbimeve me OJQ-të.

Në funksion të kontraktimit të shërbimeve sociale janë edhe disa Udhëzime Administrative, me anë të të cilave është zhvilluar dhe konsoliduar dukshëm edhe gama e organizatave, personave fizik dhe juridik të cilët mund të ofrojnë shërbime sociale, duke u nënshtruar një procedure strikte të plotësimit të kriteve dhe licencimin e tyre. Një akt i tillë nënligjor me shumë rëndësi është edhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për licencimin e organizatave jo qeveritare dhe subjekteve juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, por kontraktimi i këtyre shërbimeve duhet të rregullohet mirëfilli me norma juridike në ligjet e lartpërmendura dhe aspekte procedurale pastaj mund të specifikohen edhe me Udhëzim Administrativ.

Megjithatë, edhe përkundër ekzistimit të disa akteve juridike, që në një formë apo tjetër hapin mundësi për rregullimin e fushës së kontraktimit të shërbimeve sociale, nevojitet që dispozitat ligjore të jenë akoma më të qarta në këtë drejtim, në momentin kur të bëhet rishikimi i tyre, gjë e cila shihet se është imperativ i kohës.

Detyrimet e shtetit për mbrojtjen juridike, sociale dhe familjare të personave në nevojë janë të përhershme dhe tashmë fusha e prokurimeve publike ka një traditë afërsisht dy dekada të rregullimit ligjor në Kosovë, por që blerja e shërbimeve sociale jashtë rregullave të Ligjit për Prokurim Publik ka qenë e pamundur dhe nuk është zbatuar deri më tani.

Në funksion të kësaj ka një udhëzim të BE-së mbi prokurimin publik⁵, i cili lejon disa përjashtime nga rregullorja e prokurimit të përgjithshëm në rastin e shërbimeve shëndetësore apo sociale. Për ta nuk është i rëndësishëm përdorimi i mekanizmit të prokurimit publik, por përdorimi i një mekanizmi tjetër që reflekton më mirë kushtet specifike që lidhen më këto shërbime. Gjithsesi, nëse vlera e kontratave të tilla tejkalon një limit minimal, procedura të paktën duhet të sigurojë që është transparente dhe që të gjithë operatorët ekonomik trajtohen në mënyrë të barabartë⁶.

Me fjalë të tjera, BE lejon që shërbimet sociale të kontraktohen jo duke përdorur mekanizmin e prokurimit publik, por duke dizajnuar një mekanizëm të veçantë që mund të jetë më i thjeshtë dhe që merr në konsideratë specifikat e shërbimeve sociale dhe ofruesit potencial të tyre.

Gjithashtu, **Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (2008, i plotësuar dhe ndryshuar disa herë)**, si ligj bazik për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë në Republikën e Kosovës, rregullon mënyrën dhe procedurat e shpenzimit të parasë publike, duke përfshirë rregullimin në mënyrë tejet të përgjithshme edhe të fushës së subvencionimeve, donacioneve dhe granteve për individët, OJQ-të dhe sektorin e bizneseve, ku neni 53 i Ligjit përcakton se *Ministri i Financave ka kompetencë të nxjerrë rregulla të detyrueshme për të gjitha organizatat buxhetore kur ato ndajnë grante, donacione apo subvencione dhe mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve*, dispozitë e cila nuk është shfrytëzuar dhe as shteruar sa duhet, pasi që ajo ofron shumë mundësi për qëllimet që synohen të arrihen në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Bazuar në këto dispozita është nxjerr edhe Rregullorja MF-Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, që tenton të rregullojë në mënyrë gjithpërfshirëse mënyrën e financimit publik të OJQ-ve nga ana e organizmave buxhetore. Këto dispozita të Ligjit dhe të Rregullores nuk përcaktojnë specifikisht mundësinë e komisionimit/kontraktimit të shërbimeve sociale nga ana e OJQ-ve, megjithatë fryma e ligjit dhe e kësaj rregulloreje shkojnë në atë drejtim. Sidoqoftë pa ndryshime në legjislacion, nuk mund të themi se ekziston korniza ligjore e mirëfilltë për komisionimin/kontraktimin e shërbimeve sociale nga ana e OJQ-ve.

⁵ DIRECTIVE 2014/24/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL 26 February 2014 on public procurement and repealing Directive 2004/18/EC.

⁶ Directive 2014/24/EU, paragrafi 114 (faqe 23). Pragu i vendosur sipas nenit 4 të Direktivës është 750 000 EUR.

3.2. Nevoja për ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore për shërbime sociale me theks të veçantë për QPS-të

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë del se reforma e sistemit të mbrojtjes sociale në përgjithësi paraqet përgjigje në ndryshimet sistemore, të cilat duhen zbatuar me qëllim të harmonizimit të legjislacionit si kusht për integrim në Bashkimin Evropian. Aktiviteti në hartimin e Ligjit të ri për shërbime sociale dhe familjare do të duhej të nxiste veprimin dhe partneritetin e të gjithë akterëve social, shumëllojshmërinë dhe qasjen për të gjithë, në veçanti të formave, jashtë institucionale.

Nevoja për ndryshime ligjore dhe hartimin e ligjit të ri të integruar dhe të avancuar për shërbimet sociale dhe familjare duhet të ndodhë sa më shpejt që është e mundur, ku do të mbuloheshin zbrastësitë juridike dhe do të eliminoreshin kontradiktat që ekzistojnë në legjislacionin e fushës së shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësisve për institucionet përgjegjëse, pasi që ka kompetenca të padefinuara mirë ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal (QPS), si dhe ofruesve tjerë të shërbimeve sociale dhe familjare.

Përfundimisht, nevojiten plotësime, ndryshime dhe harmonizime të dispozitave të disa ligjeve në mes vete si: [Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare](#), [Ligji për Financat e Pushtetit Lokal](#), [Ligji për Prokurimin Publik](#), [Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë](#), si dhe ligjeve të tjera eventuale që ndërlidhen me këtë fushë, me të cilat do të hapej mundësia dhe do të krijohesh një bazë e mirëfilltë ligjore për komisionimin/kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga autoriteteve publike edhe me sektorin e Organizatave jo Qeveritare.

IV. TË GJETURAT MBI STRUKTURËN DHE FUNKSIONIMIN E QPS-VE

4.1 Struktura e Qendrës për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale është institucion publik profesional i nivelit Komunal. QPS-të si organe kryesore të autoriteteve komunale, janë të mandatuara për të ofruar kujdes social, mbrojtje sociale dhe shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë, si dhe për të koordinuar dhe organizuar një sistem të integruar të shërbimeve sociale dhe familjare brenda secilës komunë. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmës materiale për njerëzit në nevojë sociale. Struktura organizative e QPS-ve në Kosovë është si vijon:

1. **Shërbimi Social** – është shërbim profesional (grup ekspertësh) në kuadër të QPS-së që ofron shërbime sociale dhe familjare dhe kryen funksionin e Organit të Kujdestarisë (OK).
2. **Shërbimi i Asistencës Sociale** – është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Skemës së Ndhimave Sociale.
3. **Shërbimi Administrativ-Financiar** – është përgjegjës për administrimin e buxhetit dhe financave të institucionit të QPS-së si dhe punët teknike administrative.

Objekt kryesor i kësaj analize ishte **Shërbimi Social** në kuadër të QPS-ve. Sipas të dhënave të raportuar nga vetë QPS-të, mesatarja e zyrtarëve të punësuar në shërbimet sociale është 3 - 4 zyrtarë. Gjetjet e kësaj analize tregojnë se numri i zyrtarëve nuk është në proporcion me indikatorët sikurse numri i banorëve, numri i përfituesve apo numri i fëmijëve në nevojë për shërbime sociale. Përgjatë nga kjo mesatare bëjnë komunat e mëdha si Prishtina (18 punonjës në 3 njësi të saj), Mitrovica (9 punonjës), Peja dhe Gjakova (8 punonjës) dhe Prizreni (7 punonjës). Moshë mesatare e zyrtarëve në shërbimet sociale është rreth 45 vjeç (në një rang nga 25 deri në 65). Mesatarja e përvojës së punës në shërbime sociale e punonjësve është afërsisht 15 vite.

Sipas rezultateve të kësaj analize dhe të analizave paraprake, rezultojnë se krahas numrit të familjeve në nevojë dhe nevojave të komunave për shërbime, *numri i zyrtarëve të shërbimeve sociale në QPS është i mangët*. Sipas informatave nga QPS-të ka rënie të numrit të stafit. Për më tepër, ajo që rezultojnë është se *nuk ka një formulë të definuar, e cila reflekton dhe definon numrin e zyrtarëve të shërbimeve sociale kundrejt numrit të popullatës në gjendje të nevojës sociale*. E njëjta vlen edhe për profesionet specifike që ofrojnë shërbime sociale në QPS (p.sh. nevoja për psikolog, apo punonjës social).

Numri i zyrtarëve të shërbimeve sociale për komunë Mesatarja e rasteve për zyrtar të shërbimeve sociale					
Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Nr. i zyrtarëve të shërbimeve sociale	Nr. i zyrtarëve të asistencës sociale	Sa raste ka mesatarisht një zyrtar në shërbime sociale, brenda një muaji ose viti? ⁷
1	Prishtinë	218.781	18	11	318 raste në vit
2	Ferizaj	106.286	5	4	270 raste në vit
3	Kamenicë	27.948	3	4	25 raste në muaj
4	Shtime	27.449	4	3	8 raste në muaj
5	Hani i Elezit	10.09	2	1	Nuk ka të dhëna/nuk ka matje
6	Dragash	33.947	1	1	20 raste në muaj
7	Lipjan	57.928	5	6	100 raste në muaj
8	Rahovec	57.047	6	5	25 raste në muaj
9	Suharekë	58.195	4	5	Nuk ka të dhëna/nuk ka matje
10	Mitrovicë	96.331	9	8	5-6 raste në muaj
11	Kaçanik	34.672	3	3	25 raste në muaj
12	Fushë Kosovë	39.948	3	4	31 raste në muaj
13	Skenderaj	52.714	4	6	5 raste në muaj
14	Prizren	194.581	7	7	45 raste në muaj
15	Gjilan	77.145	4	5	20 raste në muaj
16	Pejë	98.601	8	6	8 raste në muaj
17	Klinë	40.49	4	5	5 raste në muaj
18	Gjakovë	94.334	8	7	50 raste në muaj
19	Istog	41.181	4	3	3 raste në muaj
20	Deçan	40.480	3	5	6 raste në muaj
21	Viti	47.896	4	4	160 raste në muaj
22	Podujevë	82.022	6	4	5 raste në muaj
23	Junik	6.383	2	2	12 raste në muaj
24	Glllogoc	61.145	7	6	Nuk ka të dhëna/nuk ka matje
25	Malishevë	57.261	5	3	20-30 raste në muaj
26	Shtërpcë	6.621	8	4	20-30 raste në muaj
27	Partesh	1.699	2	2	3-5 raste në muaj
28	Ranillug	3.737	2	2	10-15 raste në muaj

Tabela 1: Popullsia e vlerësuar sipas secilës komunë, Nr. i zyrtarëve të shërbimeve sociale sipas secilës komunë, Nr. i zyrtarëve të asistencës sociale sipas secilës komunë dhe mesatarja e rasteve për zyrtar të shërbimeve sociale

⁷ Dy nga QPS-të kanë deklaruar që nuk mund t'i nxjerrin të dhënat e rasteve për muaj, kështu që si alternative kanë dërguar të dhënat për rastet për vit.

Sipas raporteve statistikore të shërbimeve sociale në Kosovë, rezulton se mesatarja e lëndëve për një zyrtar në shërbime sociale është 85 lëndë. Sipas raportimeve nga zyrtarë të Departamenti për Politika Sociale dhe Familje (DPSF), deri në vitin 2009 është praktikuar një standard i përcaktimit të numrit të punonjësve krahas numrit të banorëve në komunë. Megjithatë, mungesa e një standardi minimal për vetë QPS-të që përcakton ndër të tjera edhe standardet për numër dhe kategori të punonjësve vazhdon të sfidojë ofrimin e shërbimeve cilësore në QPS.

Raportet e monitorimit dhe analizat paraprake tregojnë se ekziston një disbalancë gjinore në mesin e punonjësve nëpër QPS, sidomos në Komunat e vogla përkundër faktit që karakteristikat e punës sociale e kanë imperative prezencën e të dy gjinive gjatë trajtimit të klientëve bazuar në specifikat e tyre. Për më tepër, vlerësohet se *ka mungesë sensitiviteti, jo vetëm për diversitetin gjinor por edhe për diversitetin kulturor dhe etnik* në këtë aspekt, meqë në QPS në shumicën e komunave nuk ka përfaqësues të komuniteteve të tjera, konform përqindjes së popullatës përkatëse në ato komuna.

Të dhënat e raportuara nga QPS-të po ashtu tregojnë se zyrtarët e shërbimeve sociale vijnë nga profilet e ndryshme profesionale dhe janë kryesisht në përputhje me kërkesat e dala me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familje. Megjithatë, të dhënat tregojnë se ekziston një *prezencë e pabalancuar e profesioneve kundrejt nevojave profesionale për trajtim apo për natyrë të trajtimit*. Për më tepër, mungojnë analiza të strukturuar dhe sistematike të nevojave që paraqiten në QPS, e që do të informonin politikat e punësimit në QPS. Nga të dhënat aktuale të cilat disponojnë QPS-të, nuk ka analiza që dëshmojnë se janë të kërkuara apo të nevojshme profilet pëkatëse (psikolog, jurist, etj) konform statistikave të rasteve.

Rrjedhimisht, në QPS kryesisht dominon profili i juristit, pasuar nga profilet si sociolog, pedagog, psikolog dhe punëtor social. Vlen të theksohet se nga 28 Komuna, *vetëm 12 kanë raportuar se kanë profilin e punëtorit social në staf*. Po ashtu, vlen të theksohet se janë raportuar edhe profile profesionale si Edukim-Gjuhë angleze, shkollë e mesme, shkollë e lartë, ekonomist dhe administratë publike. Ndër profilet kryesore që vetë QPS-të i kanë raportuar si të mangëta dhe të nevojshme në shërbimin social janë Puna Sociale dhe Psikologjia. Po ashtu, përpos mungesës së profilizimit në aspekt akademik, *raportohet në mënyrë të theksuar edhe për mungesën e profilizimit profesional*. Të gjithë punonjësit, sipas raportimit të QPS-ve, janë zyrtarë të shërbimeve sociale të cilët caktohen menaxherë të rasteve dhe nuk ofrojnë shërbime konform profilizimit akademik dhe profesional të tyre (me përjashtim të dy psikologëve në QPS Prishtinë). Për më tej, raportohet edhe për mungesë të profilizimit të specializuar për kategori si p.sh. për viktimat e krimeve seksuale, dhunime, delikuencë të të miturve, aftësi të kufizuar, etj. Mungesa e profilizimit dhe ngarkesa enorme e punonjësve me lëndë rezulton në një gjendje që rrezikon ofrimin e shërbimeve dhe cilësinë minimale të shërbimit për përfitues. Lidhur me këtë, raportohet edhe nevoja për tu lidhur me kurrikulat parauniversitare të përgatitjes së profesionistëve, meqë është evidente se edhe në përgatitjen universitare, profesionistët e ardhshëm nuk marrin njohuri dhe shkathtësi të mjaftueshme për punën me kategoritë specifike.

Funksionimi i Organit të Kujdestarisë - QPS sipas legjislacionit në fuqi kryen funksionin e Organit të Kujdestarisë, i cili përbëhet nga grup ekspertësh (profesionistë), që janë zyrtarë të shërbimit social në QPS.

Me Ligjin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, **Zyrtar të Shërbimit Social** është përcaktuar që, profesionist të shërbimeve sociale dhe familjare duhet të jenë me kualifikim adekuat **në fushë të punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose në ndonjë lëmë tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare**, që është licencuar dhe regjistruar në regjistër të Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare. Ajo që përbën problem në funksionimin e Organit të Kujdestarisë është se të gjithë këta profesionistë duhet të jenë të punësuar brenda QPS-ve dhe secili prej tyre mund të jetë Zyrtar i Shërbimeve Sociale, por përshkrimi i detyrave duhet të dallojë dhe secili duhet të ofrojë shërbime sociale sipas kompetencës së tij/saj profesionale, e në asnjë mënyrë juristi apo sociologu të ofrojë shërbimet sociale që janë kompetencë e punëtorit social me përgatitje adekuate. Kudo që do të përcaktohet me ligj në të ardhmen, vendosja në strukturë organizative e Organit të Kujdestarisë brenda apo jashtë QPS-së, Organi i Kujdestarisë duhet t'u përmbahet dispozitave ligjore të funksionimit si trupë profesionale, ku secili Zyrtar që ofron shërbime sociale do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj në pajtim me përgatitjen e tij/saj profesionale si pjesë e trupës e përbashkët që përbëjnë Organin e Kujdestarisë. Duhet theksuar, që kjo do të ishte e mundshme me shtimin e burimeve njerëzore në QPS, e sidomos punësimin e zyrtarëve me profil të "punonjësit social" dhe "psikologut" të cilat janë raportuar si profile të munguara por të domosdoshme në QPS.

Aktualisht, përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve nga kompetenca e Organit të Kujdestarisë është Udhëheqësi i Shërbimeve Sociale në QPS. Për kryerjen e funksionit të Organit të Kujdestarisë, Drejtori i QPS me vendim autorizon udhëheqësin e Shërbimit Social, për menaxhimin e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Organit të Kujdestarisë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Udhëheqësi i Shërbimit Social, bazuar në kompleksitetin e punës sociale dhe nevojat e klientëve mund të formoj ekipe profesionale për menaxhimin dhe kryerjen e detyrave nga kompetenca e Organit të Kujdestarisë dhe Shërbimit Social në QPS.

Përbërja e ekipit profesional - Udhëheqësi i Shërbimit Social, varësisht nga rasti në nevojë për trajtim dhe ofrim të shërbimeve, formon ekipin profesional të Organit të Kujdestarisë shumë disiplinare nga zyrtarë të Shërbimit Social. Në ekipin profesional në QPS për kryerjen e funksionit të Organit të Kujdestarisë marrin pjesë: udhëheqësi i Shërbimit Social, punëtori social, juristi, psikologu dhe ekspert tjerë sipas nevojës (pedagogu, sociologu, etj.), por ekipi profesional sipas nevojës mund të plotësohet edhe me profesionist të jashtëm.

Ky ekip profesional shumë disiplinare formohet për kryerjen e funksionit të Organit të Kujdestarisë edhe në degët e QPS-së, e cila ka një ose më shumë degë. Në Qendrat për Punë Sociale me numër të vogël të zyrtarëve të Shërbimit Social për formimin e ekipit profesional të Organit të Kujdestarisë, udhëheqësi i Shërbimit Social mund të bashkëpunon me profesionist të jashtëm nga sektori publik dhe joqeveritar, brenda dhe jashtë territorit të komunës me profesionist nga: QPS tjera, komuna, shëndetësia, arsimiti, OJQ-të, etj. Edhe kjo çështje duhet të trajtohet me Ligjin e ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare, pasi që ka dilema në mes të profesionistëve të fushës së ofrimit të shërbimeve sociale.

Nr.	Komuna	Nr. i stafit në Organin e Kujdestarisë	Përbërja e Organit të Kujdestarisë të raportuara nga QPS-të
1	Prishtinë	N/A	Nuk është i themeluar Organin e Kujdestarisë, punohet vetëm me menaxher të rastit
2	Ferizaj	5	1 punëtor social, 1 psikolog, 1 sociolog, 1 pedagog, 1 jurist
3	Kamenicë	4	2 juristë, 1 sociolog, 1 punëtor social
4	Shtime	4	1 psikolog, 2 juristë, 1 sociolog
5	Hani i Elezit	3	2 sociologë, 1 pedagog
6	Dragash	1	1 jurist
7	Lipjan	5	1 punëtor social, 1 sociolog, 1 pedagog, 1 psikolog dhe 1 jurist
8	Rahovec	7	1 punëtor social, 2 psikologë, 2 pedagogë, 1 jurist, 1 ekonomist
9	Suharekë	3	1 jurist, 1 psikolog, 1 pedagog
10	Mitrovicë	9	1 Sociolog , 1 pedagog , 5 juristë dhe 2 psikologë
11	Kaçanik	2	1 jurist, 1 sociolog
12	Fushë Kosovë	4	1 pedagog, 1 sociolog, 2 juristë
13	Skenderaj	4	1 punëtor social, 1 sociolog, 1 jurist, 1 biolog
14	Prizren	4	1 punëtor social, 1 pedagog, 1 Psikolog, 1 jurist
15	Gjilan	5	2 punëtorë social, 1 pedagog, 2 juristë
16	Pejë	5	1 punëtor social, 1 pedagog, 1 psikolog, 3 juristë
17	Klinë	4	1 sociolog, 1 pedagog, 2 jursite
18	Gjakovë	7	1 punëtor social, 1 sociolog, 2 psikologë, 3 juristë
19	Istog	4	1 punëtor social, 2 pedagogë, 1 jurist
20	Deçan	3	1 pedagog, 1 sociolog, 1 ekonomist
21	Viti	4	4 juristë
22	Podujevë	6	3 Sociologë, 1 jurist, 2 punëtorë social
23	Junik	2	2 me shkollim të mesëm
24	Drenas	3	2 sociologë, 1 psikolog
25	Malishevë	5	1 punëtor social, 1 sociolog, 1 administratë, 1 jurist
26	Shtërpçë	N/A	Psikolog
27	Partesh	N/A	Nuk ka
28	Ranillug	4	2 Punëtorë social dhe 2 juristë

Tabela 2: Përbërja dhe profilet e stafit në Organin e Kujdestarisë të raportuara nga QPS-të

4.2 Të gjeturat mbi buxhetin dhe infrastrukturën

Buxheti: Ligji për Financat e Pushtetit Lokal parasheh se MFPT, Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojnë që përmes buxhetit vjetor të Kosovës komunave tu ofrohen mjetet dhe fondet e nevojshme financiare për të siguruar përmbushjen e kompetencave të deleguara në komuna, përfshirë këtu edhe ofrimin e shërbimeve sociale. QPS-të nuk e menaxhojnë buxhetin; buxheti është i centralizuar në qeverinë lokale dhe ka linja specifike buxhetore për stafin, pajisjet dhe mallrat/shërbimet, jo për shërbime sociale profesionale. Pagat e stafit administrohen nga pushteti lokal.

Sipas raportimeve të zyrtarëve të DPSF, në vitin 2010 është ndarë një grant specifik në vlerë të 2 milion eurove për shërbime social në komuna, grant ky që në vitin 2011 është përgjysmuar, për tu shkruar në tërësi në grantin e përgjithshëm në vitin 2012. Kjo shkrirje ka vënë shërbimet sociale dhe financimin e tyre në diskrecion të kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të DKSHMS-ve, të cilët prioritojnë shëndetësinë para shërbimeve sociale në financim dhe ndarje të buxhetit. Për më tej, raportohet se Qendrat për Punë Sociale asnjëherë nuk janë të përfaqësuara në proceset e planifikimit të shërbimeve sociale dhe të buxhetit për këto shërbime në kuadër të komunave.

Sipas raportimeve të QPS-ve, ka dallime të mëdha në buxhet të QPS-së nga komuna në komunë, dhe nuk gjindet ndonjë formulë apo modalitet specifik se si bëhet kjo ndarje. Disa QPS raportojnë se përpos buxhetit për paga dhe mallra, QPS-së nuk i ndahet buxhet specifik për shërbime sociale, dhe edhe në rastet nëse ndahet, QPS nuk menaxhon me të; ndërsa QPS-të e tjera raportojnë se buxheti për shërbime mbulon vetëm strehimin familjar brenda komunës dhe se kategori specifike për subvencionim të shërbimeve nuk ka. Një pjesë e QPS-ve kanë raportuar se nuk kanë fare informacion për buxhetin.

Është shqetësuese edhe gjetja se QPS-të nuk disponojnë me një fond emergjent, pavarësisht nevojës madhore për një fond të tillë.

Raporti i monitorimit nga KOMF (2021) ka gjetur se *ka mungesë të planifikimeve të shërbimeve dhe planifikimeve buxhetore bazuar në nevojat*. Për më tepër, mungon në tërësi edhe *kostimi i shërbimeve për kokë fëmijë/përfituesi në muaj për secilën kategori të veçantë*. Planifikimet buxhetore nuk bazohen në kostime konkrete apo në ndonjë analizë paraprake të nevojave në baza vjetore për shërbime sociale. Planifikimi buxhetor i komunave është i prirur të përsërisë planifikimet buxhetore paraprake, pa ndonjë vlerësim real mbi nevojat e qytetarëve për shërbime sociale. Për më tepër, ky planifikim nuk merr për bazë as nevojat e QPS-ve dhe OJQ-ve ofruese të shërbimeve sociale në komuna. Raporti më tej thekson se në Qendrat për Punë Sociale nuk ka pasur financim të veçantë nga komunat të dedikuar vetëm për shërbime sociale. E vetmja formë e financimit në disa komuna ka qenë subvencionimi me mjete monetare i familjeve strehuese, familjeve në nevojë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar. Sipas të dhënave në dispozicion, vlen të theksohet se kodi buxhetor për shërbime sociale ekziston në komuna, por nuk ka informacione të sakta për përdorimin e këtij kodi.

Hapësirat e punës: Vetëm 28% e respondentëve janë përgjigjur se për momentin kushtet infrastrukturore në objektin e QPS-së janë relativisht të mira. Shumica e zyrtarëve të QPS-ve kanë raportuar se *shërbimet e QPS-së ofrohen në hapësira të pamjaftueshme fizike, me infrastrukturë të vjetëruar dhe kushte të papërshtatshme si për stafin ashtu edhe për përfituesit dhe për ofrimin e shërbimeve sociale*. Mungesa e zyrave individuale apo edhe hapësirave për ofrim të shërbimeve individuale është raportuar se pengon trajtimin me konfidencialitet të përfituesve që paraqiten në QPS. Për më tej, është raportuar se në disa raste përfituesit duhet të kalojnë nëpër zyrat e sektorëve të tjerë, për të arritur deri te shërbimet sociale. Në raste të tjera, për shkak të mungesës së zyrës së kontaktimeve, zyrtarët në vazhdimësi duhet të lirojnë zyrat e tyre për të mundësuar kontaktimet me përfituesit. Një QPS ka raportuar se nuk kanë zyrë fare, dhe se punojnë në një objekt të përshtatur (palestër sportive).

Veturat dhe pajisjet teknike: Shumica dërrmuese e QPS-ve operojnë me *vetëm një veturë- pavarësisht madhësisë së territorit, numrit të punonjësve, numrit të përfituesve, lokacionit të QPS-së apo llojit të shërbimeve që ofrojnë*. Pothuajse në të gjitha rastet është raportuar se veturat janë kryesisht donacion, dhe janë të stër-vjetëruara, të amortizuara dhe në gjendje të rëndë. Në disa raste, QPS nuk posedon veturë dhe secilën herë që i duhet, duhet t'i bëjë kërkesë komunës për shfrytëzim të veturës. Një model që vlen të replikohet në komuna është modeli që përdorin QPS-të në Prishtinë, përmes kontraktimit të shërbimit të taksive pas orës 16:00 dhe gjatë kujdestarive, kontraktim ky që është bërë përmes zyrës së prokurimit në Komunë. Sipas QPS Prishtinë, kjo ka qenë një lëvizje shumë pozitive, me kosto të menaxhueshme që mundëson reagimin e shpejtë dhe të menjëhershëm të zyrtarëve në raste emergjente dhe monitorohet lehtë meqë faturat gjithnjë korrespondojnë me kohën e reagimit të QPS.

Në gjendje të vjetëruar dhe të amortizuara janë në të shumtën e rasteve edhe pajisjet teknike si kompjuterët, dhe jo të gjithë zyrtarët janë të pajisur me to. Për më tej, në të shumtën e rasteve mungojnë (apo nuk funksionojnë) pajisjet përcjellëse si printerët dhe makinat e fotokopjimit.

Kushtet e punës, hapësirat e zyrave, automjetet dhe paisjet teknike						
Nr.	Komunat	Veturë	Kompjuterë	Zyre/Hapësirë	Telefon	Printer/Skaner
1	Prishtinë	4 (amortizuar)	Modele të vjetra	E papërshtatshme	N/A	N/A
2	Ferizaj	1	Modele të vjetra	N/A	N/A	N/A
3	Kamenicë	1 (amortizuar)	N/A	Posedon	N/A	0
4	Shtime	1 (amortizuar)	N/A	N/A	N/A	N/A
5	Hani i Elezit	0	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon
6	Dragash	1	5 PC	Posedon	N/A	N/A
7	Lipjan	0	Posedon	N/A	N/A	N/A
8	Rahovec	2 (amortizuar)	Modele të vjetra	N/A	N/A	Posedon (Me defekte)
9	Suharekë	2 (amortizuar)	Modele të vjetra	E papërshtatshme	N/A	N/A
10	Mitrovica e Jugut	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon
11	Kaçanik	1 (amortizuar)	7 PC	N/A	N/A	N/A
12	Fushë Kosovë	2	Posedon	N/A	N/A	N/A
13	Skenderaj	2	7 PC	N/A	N/A	N/A
14	Prizren	3 (amortizuar)	Modele të vjetra	E pamjaftueshme	0	0
15	Gjilan	1 (amortizuar)	Modele të vjetra	E papërshtatshme	N/A	N/A
16	Pejë	1	N/A	N/A	N/A	N/A
17	Klinë	1	Po	N/A	N/A	N/A
18	Gjakovë	2+1 (me qera)	18 PC + 10 Tableta	19 zyre	Posedon	Posedon
19	Istog	1	8 (modele të vjetra)	Posedon	N/A	0
20	Deçan	1	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon
21	Viti	1 (amortizuar)	Posedon PC (amortizuar)	Posedon (amortizuar)	Posedon (amortizuar)	Posedon (amortizuar)
22	Podujevë	0	13 PC	11 Zyre	N/A	N/A
23	Junik	0	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon
24	Drenas	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon	Posedon
25	Malishevë	1	Jashtë funksionit	E pamjaftueshme	0	0
26	Shtërpcë	1	3	4 zyra të për-shtatshme	N/A	N/A
27	Partesh	0	Posedon PC funksional	Posedon	Posedon	Posedon
28	Ranillug	0	Posedon (modele të vjetra)	N/A	N/A	0

Tabela 3: Kushtet e punës, hapësirat e zyrave, automjetet dhe paisjet e zyrës
 *N/A është vendosur për QPS-të të cilat nuk kanë ofruar përgjigje

Qasja: Mbi 50% e QPS-ve raportohet të jenë me lokacion në qendër të qytetit, në disa raste në afërsi të qendrës dhe lehtësisht të identifikueshme për qytetarët. Megjithatë mbi gjysma e QPS-ve kanë raportuar *qasje të vështirësuar ose të pamundshme për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar*. Disa QPS kanë raportuar se janë të vendosur në katin e dytë, pa qasje në ashensor apo pjerrina të lëvizjes për persona me aftësi të kufizuara. Vetëm 8 QPS janë përgjigjur se posedojnë ambient miqësor për fëmijë për raste të kontaktimit apo ofrimit të shërbimeve për fëmijë. QPS-të e tjera kanë raportuar se nuk kanë hapësira të dedikuara dhe miqësore për fëmijët.

Organizatat joqeveritare pjesëmarrëse në këtë analizë po ashtu janë shprehur se në pjesën më të madhe infrastruktura e ndërtesave të QPS-ve është në gjendje të dobët; janë theksuar *sfida si mungesë e hapësirës dhe zyrave të përshtatshme, teknologji informative e vjetruar ose jofunksionale dhe pajisje të vjetra komunikimi, mobilje të vjetra dhe shumë pak ambiente miqësore për fëmijët*. Është theksuar edhe veçanërisht mungesa e transportit për të arritur klientët dhe partnerët në mënyrë që të koordinojnë shërbimet. Të gjitha këto konsiderohet se ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe sigurimin në kohë të komoditetit për fëmijët dhe familjet në nevojë për shërbime të QPS-së. Për më tej, OJQ-të theksojnë se mundësia e qasshmërisë të QPS-ve për punë me fëmijë dhe familjet e tyre është e ndryshme në komuna të ndryshme, por ekziston një nevojë e madhe për përmirësim. *Jo të gjitha QPS-te janë plotësisht të qasshme për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.*

Qasja dhe dhomat miqësore në Qendrat për Punë Sociale ⁸						
Nr.	Komunat	Ka qasje	Nuk ka qasje	Qasje e pjesshme	Ka dhomë miqësore	Nuk ka dhomë miqësore
1	Prishtinë			x	x	
2	Ferizaj		x			
3	Kamenicë		x		x	
4	Shtime	x			x	
5	Hani i Elezit	x				x
6	Dragash			x	x	
7	Lipjan			x	x	
8	Rahovec		x			x
9	Suharekë	x				x
10	Mitrovica e Jugut		x		x	
11	Kaçanik	x				x
12	Fushë Kosovë	x				x
13	Skenderaj	x			x	
14	Prizren			x		x
15	Gjilan		x		x	
16	Pejë		x			x
17	Klinë	x			x	
18	Gjakove	x			x	
19	Istog		x		x	
20	Deçan			x		x
21	Viti	x				x
22	Podujevë	x				x
23	Junik	x				x
24	Drenas	x				x
25	Malishevë		x			x
26	Shtërpçë		x			
27	Partesh		x			
28	Ranillug		x			

Tabela 4: Qasja dhe dhomat miqësore në QPS

⁸ Fëmijët me aftësi të kufizuara, e posaçërisht ata/ato që janë përdorues të karrocave e kanë të pamundur t'i qasen shumicës së Qendrave për Punë Sociale. Po ashtu, në QPS nuk ka sinjalistikë dhe ofrohen kushtet minimale krahas standardeve.

Menaxhimi i të dhënave: Proceset e strukturuar të menaxhimit të të dhënave nuk janë në tërësi funksionale. Në rradhë të parë raportohet se *databaza e shërbimeve sociale nuk furnizohet mjaftueshëm dhe në mënyrë të rregullt me të dhëna*, por edhe ato të dhëna që futen në databazë nuk përdoren as për planifikim të shërbimeve apo buxhetit, e as si bazë për zhvillim të programeve apo politikave.

4.3 Shërbimet e Qendrës për Punë Sociale

Respondentët raportuan mbi 40 kategori të ndryshme përfituesish që janë në nevojë për shërbime sociale, për të cilët QPS ofron shërbime që nga identifikimi e vlerësimi fillestar deri të referimi, këshillimi, menaxhimi i rastit dhe ofrimi i shërbimeve konkrete varësisht nga plani i shërbimeve, dhe përfundimisht mbyllja e rastit. Disa nga këto shërbime janë raportuar që i ofrohen drejtpërdrejtë individit apo familjes në ambientet e QPS-së, përderisa të tjerat janë shërbime që janë të bazuara në komunitet, në qendra të kujdesit ditor apo në qendra rezidenciale. Në disa raste, këto shërbime ofrohen në partneritet me shërbime tjera publike apo me bashkëpunime të themeluara me organizatat joqeveritare. Nga një vështrim mbi shërbimet e listuara nga QPS-të vërehet se *një pjesë e shërbimeve lidhet me detyra juridike dhe administrative* (si lëshimet e vërtetimeve, marrja e deklaratave, kërkesat nga institucionet ndërlidhëse, etj).

Detyrat profesionale të QPS ndërlidhen me vlerësimin, këshillimin, fasilitimin e kontaktimit mes familjarve, dhënies së mendimit profesional/vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në format themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, për personat me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar, referimi i rasteve për marrjen e shërbimeve të specializuara adekuate sipas kategorive në sektorin joqeveritar, etj.

Analiza nxjerr në pah se *mbingarkesa me punë dhe raste është e dukshme në pothuajse të gjitha QPS-të*. Gjatë vitit 2022, në komuna të vogla si Juniku janë ofruar rreth 200 shërbime, përderisa në komunat si Prizreni e Gjakova numri i shërbimeve është rreth 4000 sosh. Ka raste kur ky numër shkon deri në 16 mijë. Këto shërbime natyrisht përfshijnë shërbime si vizitat në shtëpi, vizita institucionale, sesione këshilluese, seanca gjyqësore, dhënie mendimesh, etj. Në dy komuna numri i rasteve aktive kalon shifrën 5000 aktualisht (Prishtinë, Mitrovicë), në komunat e tjera 2000 deri në 3000 (Prizren, Pejë, Ferizaj, Therandë, Fushë Kosovë). Komunat me mbi 1000 raste aktive janë 4 (Malishevë, Gjakovë, Viti, Gjilan) ndërsa të tjerat nën 1000 raste aktive. Komunat me më pak raste aktive janë komunat e vogla si Juniku, Hani i Elezit, dhe Sharri.

Ky numër dallon nga komuna në komunë edhe nëse shikohet si përqindje në raport me numrin e popullsisë në ato komuna. *Ka dallime të mëdha në ngarkesën mesatare të punonjësve të shërbimeve sociale, që sërish duket se nuk ndjek ndonjë model apo formulë përkatëse*. Nga një mesatare prej nën 10 raste aktive për një zyrtar në tetë komuna, e deri në një mesatare prej 100-150 raste aktive për një zyrtar në komunat e tjera. Dy ekstreme janë evidentuar në komunën e Ferizajit (270) dhe komunën e Prishtinës (318). Sipas raporteve statistikore të DPSF në vitin 2021, raportohet se mesatarja e lëndëve për një zyrtar në shërbime sociale është 85 lëndë.

Në pyetjen se sa shpesh një zyrtar i shërbimeve sociale viziton një familje mesatarisht, QPS-të kanë dhënë përgjigje nga më të ndryshmet, nga një herë në muaj, në dhjetëra herë, gjithnjë duke theksuar se varet nga rasti dhe nga nevoja.

Kategoritë më të shpeshta me të cilat janë të ngarkuara QPS-të, pothuajse unanimisht janë theksuar të jenë dhuna në familje, problemet bashkëshortore (shkurorëzimet, besimi i fëmijëve) dhe fëmijët me sjellje asociale (delinkuenca e të miturve), pasuar tek disa QPS edhe nga aftësia e kufizuar. Shumica e QPS-ve janë dakorduar se ka edhe shërbime të shumta që mungojnë në QPS dhe në Komunën e tyre, duke theksuar në veçanti shërbimet profesionale të psikologut dhe shërbimet me bazë në familje.

Në nivel vendi *mungon një hartëzim i shërbimeve dhe nevojave të popullatës për shërbime* që do të informonte edhe politikëbërjen e edhe hartimin e programeve dhe planifikimin e shërbimeve konform nevojave. Në mesin e sfidave kryesore që i kanë theksuar në raport me shërbimet janë mungesa e kompetencës për blerjen e shërbimeve dhe mungesa e mjeteve financiare për shërbimet e menjëhershme (emergjente).

Grafiku më poshtë paraqet disa shërbime shtesë të domosdoshme të cilat nuk ofrohen nga QPS, e që janë prezente në Komuna. Sipas këtij grafikoni, QPS-të kanë raportuar se shërbime të kujdesit ditor ka në 38.5% të komunave, shërbime të strehimit familjar në 80.8%, shërbime edukative (jashtëkurrikulare) në 53.8%, shërbime profesionale për fëmijë me aftësi të kufizuara në 69.2%, shërbime për të moshuar në 46.2% dhe shërbime të strehimit emergjent në 57.7% të komunave. Dy QPS janë përgjigjur se asnjë nga këto shërbime nuk është prezente në komunën e tyre dhe QPS është i vetmi shërbim në dispozicion për fëmijët dhe familjet në nevojë.



Grafikoni 1: Shërbime shtesë të domosdoshme të cilat nuk ofrohen nga QPS, e që janë prezente në Komuna të raportuara nga QPS-të

Në pyetjen se cilat shërbime mungojnë më së shumti, QPS-të kanë identifikuar shërbimet për strehim emergjent, shërbimet e specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbimet psiko-sociale dhe edukative për fëmijët në situatë rruge, për fëmijët me sjellje asociale dhe për fëmijët përdorues të substancave, qendrat ditore si dhe shërbimet e strehimit për viktimat e dhunës, viktimat e gjinisë mashkullore mbi 12 vjeç dhe viktimat e komunitetit LGBTI. Po ashtu, mungojnë modalitetet e strehimit familjar për kategoritë e veçanta dhe mbështetja për fëmijët në nevojë pas moshës 18 vjeçare (kryesisht fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët pa përkujdesje prindërore).

Organizatat joqeveritare pjesëmarrëse në këtë analizë janë shprehur se përgjithësisht nëpër QPS nuk ofrohen shërbime direkte për shumë kategori të fëmijëve dhe të rriturve. Për shembull, është theksuar se në raport me personat me aftësi të kufizuara në QPS ofrohet asistencë materiale dhe vizitat e rregullta monitoruese lidhur me skemën për mbështetje familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, por jo edhe shërbimet si puna psikologjike, edukative apo këshilluese. Njëjtë në raport me fëmijët pa kujdes prindëror, është raportuar se pas vendosjes në kujdes alternativ, OJQ-të marrin përsipër rehabilitimin, punën psikologjike, pedagogjike, sociale dhe këshilluese, fuqizimin dhe reintegrimin, përderisa QPS realizon vizita monitoruese. Vlen të përmendet që edhe vizitat monitoruese nuk mund të realizohen me rregull për shkak të ngarkesës shumë të madhe me raste, me llojllojshmëri shërbimesh dhe pamundësisë për të arritur tek të gjithë përfituesit.

Si shërbime bazike që mungojnë në QPS, dhe rrjedhimisht edhe në komuna, OJQ-të në veçanti kanë theksuar shërbimet e parandalimit dhe shërbimet e specializuara rehabilituese dhe reintegruese për kategori të veçanta, sikurse, fëmijët e përfshirë në punë të rënda, përdoruesit e substancave narkotike, personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës.

4.4 Bashkëpunimi dhe Koordinimi

Bashkëpunimi është një pikë që QPS-të e konsiderojnë përgjithësisht si shumë pozitive dhe funksionale. Është theksuar bashkëpunimi dhe koordinimi shumë i mirë me institucionet e tjera shtetërore publike si policia, gjykata, shërbimet mjekësore dhe ato edukative. Në disa raste është theksuar nevoja për fuqizimin e sistemit të referimit mes institucioneve. Janë theksuar vështirësi në zinxhirin e referimeve si vështirësi e nivelit lokal. Tashmë është instaluar një sistem në nivelin lokal që përfshin QPS-të, Ekipet për Mbrojtjen e Fëmijëve (në 12 komuna), Tryezat për Menaxhimin e Rasteve dhe zyrtarët për mbrojtje të fëmijëve. Megjithatë, nuk janë të specifikuar modalitetet e bashkëpunimit, koordinimit dhe referimit mes këtyre strukturave.

Theks i veçantë i është vënë edhe bashkëpunimit shumë të mirë me sektorin joqeveritar dhe shërbimet sociale joqeveritare si një mundësi për plotësimin e zbrazëtive ekzistuese në shërbime sociale dhe qasje më multidisiplinare. Megjithatë, si sfida është identifikuar *mungesa e OJQ-vë në shumë komuna dhe pamundësia e kontraktimit të shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme.*

Nga këndvështrimi i OJQ-ve, bashkëpunimi dhe koordinimi me partnerët në nivelin lokal është raportuar të jetë i drejtë dhe profesional (d.m.th. me shkollat, policinë, gjykatat, institucionet e shëndetit mendor, spitalet, strehimoret, qendrat rinore, etj.). Është theksuar se në disa raste, në disa QPS, mungon një zinxhir komunikimi dhe koordinimi dhe QPS-të nuk marrin informata kthyesë nga partnerët me të cilët bashkëpunojnë. Sipas respondentëve, rëndësia e koordinimit dhe bashkëpunimit të QPS-së me partnerë të tjerë në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve në referim si dhe në ofrimin e shërbimeve është thelbësore dhe kërkon avancimin e mëtejshëm me mekanizmat e ndryshëm të koordinimit.

4.5 Zhvillimi profesional i punonjësve

QPS-të kanë raportuar se përgjithësisht të gjithë zyrtarët e shërbimeve sociale konsiderohen të mirë përparuar dhe kualifikuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre. Sfidë është theksuar një *trend i largimit të zyrtarëve të shërbimeve* (ndërrim i vendit të punës) dhe *mungesa e një programi të vazhdueshëm për zhvillim profesional*. Trajnimet e ofruara janë theksuar si të pakta dhe jo të bazuara në analizë të mirëfilltë të nevojave. Është theksuar mungesa e trajnimeve të specializuara për shërbime dhe kategori më të ndjeshme. Shumica e QPS-ve (68%) kanë theksuar se mungojnë trajnimet dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional për të plotësuar nevojat e përfituesve për shërbime cilësore. Numri i ditëve të trajnimit që zyrtarët kanë ndjekur në vitin e fundit sillet nga 0-3 (4 QPS) e deri në 10 ditë (4 QPS).

Në pyetjen se sa është e nevojshme të investohet në trajnimet e zyrtarëve, të gjitha QPS-të janë pajtuar që është shumë e nevojshme. Janë specifikuar tri lloje të trajnimeve të nevojshme: 1. *Trajnimet lidhur me ndryshimet legjislative dhe zbatimin e politikave*, në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëria e tyre në praktikë; 2. *Trajnimet për rastet specifike të ndjeshme* si dhuna në familje, dhuna seksuale, puna me viktimat e trafikimit, puna me fëmijët e riatdhesuar, puna me të miturit, me përdoruesit e substancave, etj. dhe 3. *Trajnime të shkathëtësive praktike* si ato të komunikimit, vlerësimit të rastit, trajtimit të rastit, etj. Përpos trajnimeve, janë specifikuar në mënyrë të qartë edhe shërbime mbështetëse për zyrtarët e shërbimeve sociale si parandalimi i konsumit profesional dhe emocional, supervizioni profesional dhe mentorimi kolegjial si masa mbështetëse dhe fuqizuese për punonjësit.

Në aspektin e zhvillimit profesional, sfidat kryesore që janë theksuar përfshijnë *mungesën e mbështetjes profesionale, punën e paprofilizuar/shkollimin joadekuat, djegjen profesionale, stimulimin shumë të dobët dhe mungesën e trajnimeve profesionale për stafin*. Në raport me shkollimin joadekuat, përpos profilit akademik, është theksuar edhe mungesa e harmonizimit në përgatitje të profesionistëve të ardhshëm nëpër njësi akademike dhe një nevojë për integrim të përmbajtjeve në njësitë e ndryshme akademike dhe një ndërlidhje më e mirë e kurrikulave akademike me nevojat e tregut të punës.

Nga këndvështrimi i OJQ-ve, është theksuar se përkundër kërkesave për rritjen e fuqisë punëtore të punës sociale, përkundrazi, numri i zyrtarëve për shërbime sociale në Kosovë është zvogëluar pasi shumë pozita të lira në QPS (për shkak të pensionimit, vdekjes ose dorëheqjes) në shumë QPS nuk janë zëvendësuar me personel të ri. Gjithashtu, është vërejtur se ka mungesë të profileve profesionale të stafit për të punuar me raste komplekse (shumica e punonjësve është theksuar të jenë me profil juridik, e jo psiko-social); ka mungesë të stafit ndihmës (p.sh. nëpunës administrativ në QPS-të më të mëdha); ka shumë pak trajnime të profilizuara dhe numër i konsiderueshëm i punonjësve të stërngarkuar, të djegur profesionalisht dhe të pamotivuar për shkak të pagave të vogla dhe mungesës së mbështetjes profesionale, të cilët kryesisht janë jo të gatshëm për të mësuar dhe përfshirë teorinë bashkëkohore sociale në punën e tyre praktike.

4.6 Sfidat e funksionimit

Analiza ka nxjerrë në pah disa sfida konkrete që vështirësojnë funksionimin e QPS-ve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Disa nga këto sfida janë listuar më poshtë:

Sfidat në aspektin ligjor:

- Ligji në fuqi për Shërbime Sociale dhe Familjare është kryesisht i orientuar drejt shërbimeve për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale, duke lënë anash shërbimet e parandalimit dhe reintegrimit. Ky ligj nuk bën ndarjen e qartë të përgjegjësive të institucioneve në nivel komunal dhe qendror. Po ashtu, ky ligj nuk parasheh licencimin e shërbimeve sociale të ofruara nga QPS-të. Sipas ligjit në fuqi inspektimi nuk ka kompetenca ekzekutive dhe për pasojë nuk parasheh aplikimin e masave, gjobave dhe sanksioneve.
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal nuk parasheh rregullimin e financimit të shërbimeve sociale përmes një granti të veçantë. Problemi për financimin e shërbimeve sociale fillon pikërisht këtu, sepse forma aktuale e financimit nga granti i përgjithshëm nuk ofron garanci që do të ketë ndarje të mjaftueshme të buxhetit nga komunat për të siguruar minimumin e financimit për shërbime sociale.
- Në Kosovë akoma nuk është nxjerrë formula e financimit për shërbime sociale e si pasojë nuk ka kosto për njësi për secilin shërbim të ofruar. Kjo pamundëson planifikimin dhe ndarjen buxhetore bazuar në nevojat e klientëve për shërbime sociale.
- Ligji për Prokurimin Publik nuk ofron bazën e përshtatshme ligjore për blerjen e shërbimeve sociale pasi nuk parasheh një mekanizëm të veçantë dhe më të thjeshtë të blerjes së shërbimeve, që merr në konsideratë specifikat e shërbimeve sociale.
- Qendrat për Punë Sociale nuk kanë statute unike dhe rregullore bazuar në Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Sfidat në aspektin strukturor dhe funksional:

- Mungesa e burimeve adekuata njerëzore në QPS dhe mungesa e buxhetit vetanak ndikojnë në sasinë dhe në cilësinë e shërbimeve. Mosdefinimi i standardit për numër të punonjësve dhe numër të popullsisë dhe rasteve rezultojnë në ngarkesë të madhe të punës.
- Ka një disproporcion në numrin e profileve brenda QPS-ve. Dominon profili i juristit, përderisa konstatohet mungesë dhe nevojë e madhe e profilit të punëtorit social dhe psikologut.
- Infrastruktura e vjetëruar, mungesa e dhomave miqësore për fëmijë dhe e qasjes për persona me aftësi të kufizuar paraqiten si sfida të mëdha në QPS.
- Mungesa e automjeteve, inventarit dhe pajisjeve të punës për të realizuar detyrat dhe përmbushur përgjegjësitë.
- Mungesa e fondit emergjent.
- Organogrami në QPS mbetet jo mirë i definuar dhe kërkon revidim dhe strukturim të qartë. Mungon një përshkrim i saktë i detyrave dhe obligimeve të punës për Drejtorin e QPS-së, Udhëheqësin e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe për zyrtarët e shërbimeve sociale.
- Ka një moskuptim dhe keqkuptim esencial të Organit të Kujdestarisë dhe mënyrës së organizimit të këtij organi brenda QPS, gjë që reflektohet negativisht në mbrojtjen e të drejtave të kategorive të caktuara të klientëve në nevojë.
- Statusi i zyrtarëve si shërbyes civil, nuk përkon me detyrat dhe përgjegjësitë që kryen stafi i QPS, si dhe demotivon punën e tyre.
- Nuk ka një studim për hartëzimin e shërbimeve dhe nevojave në komuna, cilat shërbime do të ofrohen nga QPS dhe cilat shërbime do të blihen përmes procedurave të prokurimit.
- Mungesa e kapaciteteve të QPS-ve në planifikim dhe menaxhim buxhetor.
- QPS dhe Komunat nuk kanë instrumentet dhe kapacitetet e nevojshme për monitorim të shërbimeve sociale. Mungon një sistem i monitorimit i koordinuar dhe i bashkërenduar nga komunat.
- Mungojnë programe të akredituara për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të shërbimeve sociale në QPS.
- QPS-të kanë një sistem funksional për mbledhjen e të dhënave lidhur me përfituesit e tyre dhe shërbimet e ofruara, përmes formularëve të standardizuar dhe pastaj raportojnë për to në intervale të rregullta. Megjithatë, mos-përditësimi i rregullt me të dhëna, paraqitet si problem. Po ashtu, nuk ka një kontroll të cilësisë dhe saktësisë së të dhënave, që sfidojnë sigurimin e cilësisë të lartë të të dhënave.

V. REKOMANDIMET

Nga aspekti ligjor, Qeveria përmes Ministrive të linjës duhet urgjentisht të procedojë për miratim:

Projektligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare:

- Nevoja për ndryshime ligjore dhe hartimin e ligjit të ri të integruar dhe të avancuar për shërbimet sociale dhe familjare duhet të ndodhë sa më shpejt që është e mundur, ku do të mbuloheshin zbrazëtitë juridike dhe do të eliminoheshin kontradiktat që ekzistojnë në legjislacionin e fushës së shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi për institucionet përgjegjëse, pasi që ka kompetenca të padefinuara mirë ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal (QPS), si dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale dhe familjare.
- Me Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të ndodhë zgjerimi i gamës së shërbimeve sociale dhe familjare, me theks të veçantë atyre të parandalimit dhe re integrimit, si dhe të hapet perspektivë edhe më e madhe për sektorin jo qeveritar dhe atë privat; Kjo do të ndikonte që QPS të lirohet nga një pjesë e shërbimeve dhe të rrisë cilësinë në ofrimin e shërbimeve që do të ofrojë, duke ndryshuar qasjen nga ajo reaktive siç është tani, në atë proaktive.
- Me Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të bëhet rishikimi dhe klasifikimi, ndryshe dhe shumë më i avancuar i llojeve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe të bëhet klasifikimi i tyre në sistem informativ dhe planifikim në tërësi.
- Me Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, duhet të bëhet fuqizimi i QPS-ve për avancimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare përmes licencimit të detyrueshëm të shërbimeve të ofruara nga QPS-të.
- Me Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, duhet të fuqizohet llogaridhënia përmes dhënies së kompetencave ekzekutive të organit përkatës për inspektim.
- Në Ligjin e ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare, duhet të eliminohen të gjitha paqartësitë dhe dilemat ligjore dhe praktike, të cilat ekzistojnë aktualisht lidhur me Organin e Kujdestarisë, si në aspektin organizativ, e gjithashtu edhe në aspektin funksional.

Projektligjin për Financat e Pushtetit Lokal:

- Krijimi i grantit specifik për shërbimet sociale dhe familjare. Ky grant duhet të jetë krahas granteve për arsim dhe shëndetësi si grant specifik për shërbime sociale. Granti Specifik për Shërbime Sociale do të duhet të përmbajë kriteret e qarta në mënyrë që të sigurojë ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale.

Formula e financimit për shërbimet sociale:

- Kostimi adekuat, sensitiv gjinor, i shërbimeve sociale dhe familjare. Formula e financimit për shërbime sociale duhet të nxjerrë koston për njësi për secilin përfitues për shërbime sociale si dhe duhet të marrë parasysh kriteret dhe indikatorët social në komuna.

Ligji për Prokurimin Publik:

- Plotësimi ndryshimi i Ligjit për Prokurimin Publik për krijimin e një mekanizmi të veçantë dhe më të thjeshtë të blerjes së shërbimeve, që merr në konsideratë specifikat e shërbimeve sociale dhe ofruesit potencial të tyre. Për shkak të ndjeshmërisë së shërbimeve sociale, ato duhet të paraqiten si kategori e veçantë në Ligjin për Prokurimin Publik.

Ndryshimet e Rregulloreve komunale për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës:

- Organizimi dhe Sistematizimi i vendeve të punës, si dhe profilizimi i funksioneve dhe pozitive (vendet e punës) brenda QPS-ve duhet të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 06/I -113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Në këtë drejtim duhet të ndodhë krijimi dhe organizimi i një strukture unike për të gjitha QPS-të, me disa njësi brenda QPS-ve, me profile të ndara akademike dhe sipas kategorive sociale që do të kryejnë funksione dhe detyra në fusha specifike, duke përfshirë edhe Organin e Kujdestarisë, si njësi organizative brenda QPS-së.
- QPS-të duhet të kenë statutin unik dhe rregulloren e brendshme, si dhe strukturën organizative bazuar në Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Kjo strukturë organizative duhet të parashohë përpos zyrtarëve të shërbimeve sociale edhe zyrtarët si ekonomist, jurist, zyrtar për planifikim, për burime njerëzore dhe për administratë dhe financa.

Nga aspekti strukturor dhe funksional, rekomandohet:

- Ministria duhet të përcaktojë formulën e punësimit të zyrtarëve të shërbimeve sociale në Kosovë konform nevojave të popullatës dhe krijimi i standardeve minimale për përcaktimin e ngarkesës së stafit dhe numrit mesatar të rasteve. Këto standarde duhet të parashohin edhe profilizimin akademik dhe profesional, e edhe diversitetin gjinor dhe etnik në mesin e shërbyesve social konform nevojave të popullatës. Rekomandohet që pas përcaktimit të formulës, të bëhet pilotimi në 3 komuna para se të zbatohet gjerësisht.
- Rritja e numrit të zyrtarëve me profil të "punonjësit social" dhe "psikologut" në të gjitha QPS-të dhe punësimi i profilit të punonjësit social në institucione ndërlidhëse (shkolla, polici, qendra mjekësore, etj.) për të kontribuar drejt interesit më të mirë të fëmijëve dhe popullatës në përgjithësi, si dhe për krijimin e përshkallëzimeve në shërbimet sociale që jo të gjitha shërbimet të nisin dhe përfundojnë në QPS.
- Sigurimi i hapësirave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të punës në QPS, të cilat nuk i posedojnë këto hapësira. Sigurimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në objektet e QPS-ve sipas standardeve të përcaktuara në U.A., 33/2007 si dhe atyre ndërkombëtare.
- Sigurimi i dhomave miqësore dhe të qasshme për fëmijë në objektet e QPS-ve.
- Pajisja me automjete shtesë për stafin e QPS për ofrimin e shërbimeve sociale në familje dhe komunitet. Pajisja me automjete duhet të bëhet në proporcion me numrin e banorëve dhe numrin e rasteve në QPS në komuna.

- Furnizimi me inventar (kompjuterë, printer dhe pajisjet e tjera të zyrës) për të mundësuar funksionimin e nevojshëm të QPS-ve.
- Përcaktimi i fondit emergjent dhe autorizimi i QPS-ve për shpenzim të fondit.
- Rishikimi i organogramit të QPS-së dhe rishikimi i përshkrimeve të punës së stafit.
- Hartëzimi i shërbimeve ekzistuese sociale dhe nevojave aktuale në secilën komunë, për të identifikuar saktësisht shërbimet që mungojnë dhe për të planifikuar zhvillimin e tyre. Kjo do të ndihmonte edhe në planifikim real vjetor të shërbimeve konform nevojave dhe planifikim buxhetor të bazuar në dëshmi.
- Përcaktimi i shërbimeve sociale të cilat mund të ofrohen nga QPS. Shërbimet të cilat nuk mund të ofrohen nga QPS duhet të paraqiten në planin vjetor për prokurim publik për blerje të atyre shërbimeve nga sektori joqeveritar ose privat.
- Ngritja e kapaciteteve të QPS-ve në planifikimin buxhetor, sensitiv gjinor dhe menaxhim të buxhetit për shërbime sociale.
- Ndërrimi i statusit të zyrtarëve për shërbime sociale nga shërbyes civil në shërbyes profesional.
- Hartimi dhe akreditimi i programit të strukturuar për zhvillim të karrierës për zyrtarët e shërbimeve sociale (program unik i akredituar).
- Krijimi i mekanizmave për mbështetje profesionale dhe parandalim të djegies profesionale të punonjësve si funksionalizimi i supervizionit mbështetës, professional dhe investimi në mirëqenien psikologjike të tyre si dhe mbrojtjen dhe sigurinë në punë.
- Përcaktimi i metodologjisë së monitorimit dhe mjeteve të vetë-vlerësimit brenda strukturave të QPS-ve dhe mekanizmave komunal për të siguruar cilësi të shërbimeve.
- Rishikimi dhe modifikimi i bazës së të dhënave të QPS-ve dhe gjetja e modaliteteve për menaxhimin e të dhënave me qëllim të informimit në kohë reale, duke përfshirë edhe të dhënat për përfituesit nga ofruesit jo qeveritar dhe privat të shërbimeve sociale, monitorimit dhe vlerësimit.
- Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet QPS-ve dhe OJQ-ve të licensuara në ofrim të përbashkët të shërbimeve sociale dhe referim të rasteve përmes Protokolleve dhe Udhëzuesve Bashkëpunues/Referues.

KOSTIMI I ANALIZËS

Qëllimi i kostimit të rekomandimeve të analizës

Në kuadër të këtij kapitulli, do të paraqitet kostimi i rekomandimeve të dala nga Analiza për gjendjen e Qendrave për Punë Sociale. Qëllimi i këtij kostimi është të përcaktojë buxhetin e nevojshëm për përmbushjen e rekomandimeve të dala nga analiza. Rekomandimet e analizës i adresohen komunave dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, prandaj ato do të kostohen në mënyrë specifike, me qëllim të qartësisë të përgjegjësisë për ndarje të buxhetit për adresimin e rekomandimeve.

Analiza për gjendjen e QPS-ve adreson sfidat dhe rekomandimet në aspektin ligjor, strukturor dhe funksional. **Megjithatë, nisur nga nevoja për ndërhyrje emergjente, më poshtë janë kostuar rekomandimet strukturore të cilat janë thelbësore për funksionimin e shërbimeve sociale.**

Gjendja aktuale e financimit të shërbimeve sociale në Kosovë

Financimi për shërbimet sociale dhe familjare për vitin 2023 është 10.2 Milion EUR, nga të cilat rreth 7,9 Milion EUR financohen nga Granti i Përgjithshëm për kostot operative të QPS-ve, duke përfshirë disa kosto të investimeve kapitale, kurse rreth 2,3 Milion EUR financohen nga buxheti i nivelit qendror për tetë shtëpitë e komunitetit për persona me aftësi të kufizuar dhe pesë shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar.


Financimi i lartpërmendur i QPS-ve mbulon pagat, shpenzimet e minimale të mallrave dhe shërbimeve, si dhe shpenzimet komunale. Ndërsa pjesa e mbetur shërben për investime kapitale dhe menaxhohet nga niveli qendror.

Financimi aktual nuk mbulon koston e shërbimeve të parandalimit dhe reintegritit dhe as shërbimet emergjente për mbrojtje të ofruara nga QPS-të.

Ndërkohë shërbimet sociale të specializuara të cilat nuk mund të ofrohen nga QPS-të, aktualisht ofrohen nga sektori joqeveritar sikurse shërbimet e specializuara ditore, shërbimet në familje, shërbimet me bazë në komunitet dhe ato rezidenciale. Megjithatë, edhe këto shërbime rrezikojnë në mënyrë të vazhdueshme qëndrueshmërinë për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm.

Kostimi i rekomandimeve të analizës

Rekomandimet e kostuara apo financimi në vijim mbërrin vlerën prej 3,644,640 Milion EUR. Nëse këtë implikim financiar e shohim nga këndvështrimi i llojit të shpenzimeve, shpenzime operative/ rrjedhëse apo të përvitshme, janë 1,83 Milion EUR, ndërsa pjesa tjetër prej 1,82 Milion EUR është investim kapital apo i njehershëm që duhet të përsëritet çdo 5 vite.



Financim shtesë i përvitshëm i Qendrave për Punë Sociale

Financimi komunal i përvitshëm shtesë për QPS-të është llogaritur në vlerë prej 1,826,640 EUR dhe mbulon këto kategori:

Bazuar në rekomandimet e analizës është menduar shtimi i numrit të zyrtarëve të shërbimeve sociale dhe ngritja profesionale e tyre. Aktualisht në sektorin e shërbimeve sociale pranë QPS-ve janë 164 zyrtarë të shërbimeve sociale të punësuar. Duke rritur numrin e stafit edhe për 200 të tjerë mundësohet rritja e cilësisë së shërbimeve sociale. Për më tepër, me shtimin e numrit të zyrtarëve në QPS do të mundësohet plotësimi i kuadrove apo profileve të nevojshme për kompletimin dhe funksionimin e Organit të Kujdestarisë.

Paga mujore prej 577.00 EUR është paraparë për një zyrtar të QPS-së dhe kostoja totale për 200 zyrtarë në vit rezulton me 1,384,800 EUR.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, është vlerësuar që secili zyrtar të mbajë tre trajnime të përzgjedhura. Secili trajnim kushton rreth 120 EUR për një zyrtar, përderisa implikimi vjetor për 364 zyrtarë të shërbimeve sociale kushton 131,040 EUR.

Përveç personelit është parë e nevojshme që QPS-të të kenë një fond emergjent në formë të peti keshit ku rimburohen me fatura për shpenzimet e paparashikuara (sikurse një vakt ushqimor për viktimat e dhunës, qumësht, rroba dhe veshmbathje për një foshnje të braktisur, etj.), gjëra që blihen gjatë 24 orëve të punës së QPS-së. Ky fond është paraparë në baza mujore. Shuma e fondit emergjent me peti kesh për komunën e Prishtinës është paraparë të jetë në vlerë prej 800 EUR në muaj, për 6 komunat e tjera të mëdha është paraparë në vlerë prej 600 EUR në muaj, kurse për 31 komuna të tjera peti keshi është paraparë në vlerë prej 400 EUR në muaj. Para për fondin emergjent për 12 muaj për 38 QPS-të do të rezultojë me 201,600 EUR në vit. Përlllogaritja e shumës së peti keshit është bërë në bazë të numrit të rasteve në komuna.

Me qëllim të mbështetjes së mirëqenies psikologjike dhe parandalimit të djegies profesionale të zyrtarëve, është paraparë një fond prej 300 EUR në vit për secilin zyrtar që të shpenzohet për shëndetin mendor të tyre duke përfshirë supervizimin mbështetës, me implikim total vjetor në vlerë prej 109,200 EUR.

Shpenzimet operative apo rrjedhëse të përvitshme për komunat	Vlera vjetore
3 trajnime 3 ditore të përzgjedhura gjatë vitit për secilin zyrtar (364 zyrtarë) (3 trajnime nga 120 EUR/trajnim x 364 zyrtarë).	€ 131,040
Pagat për 200 zyrtarë të rinj të rekrutuar 577 EUR pagë mujore x 12 muaj.	€ 1,384,800
Fondi emergjent (peti kesh) në baza mujore për secilën prej 38 QPS-ve ekzistuese.	€ 201,600
Supervizimi psikologjik për zyrtarët aktual dhe zyrtarët e rinj. 300 EUR në vit për secilin prej 364 zyrtarëve që menaxhojnë raste në QPS.	€ 109,200

3. Financimi i njëhershëm apo investimi kapital për QPS-të

Financimi i një hershëm apo investimi kapital prej 1,818,000 EUR është një investim i cili mundëson punën e 364 zyrtarëve me pajisje themelore, përmirëson qasjen fizike për persona me aftësi të kufizuara në hapësirat e QPS-ve dhe tualetet sipas standardeve për personat me aftësi të kufizuar, si dhe krijon hapësira mike për fëmijë.

Për më shumë detaje shih ndarjen e shpenzimeve në kategori:

Shpenzimet e njëhershme apo investimet kapitale	Vlera vjetore
Kënd pune që përfshin inventarin (tavoline karrige, kompjuter e printer për secilin zyrtar)	€ 364,000
Blerja e makinave dhe mirëmbajtja përfshirë obligimet vjetore për 5 vite	€ 1,200,000
Adoptimi i dhomave mike	€ 54,000
Rehabilitimi i qasjes në QPS dhe banjove	€ 200,000

Krijimi i kushteve për punë për 364 zyrtarët të cilët kanë nevojë për tavolinë pune, karrige, kompjuter, printer e telefon, është llogaritur në vlerë prej 1,000 EUR për secilin zyrtar e që rezulton me kosto prej 364,000 EUR në total.

Për të përmbushur nevojën e vizitave në familje dhe terren, është vlerësuar se është e nevojshme blerja e makinave për secilën QPS në varësi të shtrirjes territoriale dhe rasteve në trajtim. Për këtë nevojitet blerja e 60 makinave në vlerë prej 20,000 EUR (përfshirë obligimet vjetore për 5 vite) që rezulton me kosto prej 1,200,000 EUR në total.

Për krijimin e një dhome mike për fëmijë është menduar renovimi dhe blerja e inventarit dhe lodrave në vlerë prej 2,000 EUR për 27 QPS (të cilat kanë raportuar që nuk posedojnë dhoma mike). Kjo ndërhyrje në total do të kushtojë 54,000 EUR.

Përveç inventarit dhe pajisjeve pranë QPS-ve, nevojitet investim që të mundësohet qasja gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuar. Adoptimi i QPS-ve për qasje fizike për persona me aftësi të kufizuar ka koston 5,000 EUR për secilën QPS, që respektivisht për 40 objekte në total do të kushtojë 200,000 EUR.

SHTOJCA 1

Lista e QPS-ve që kanë marrë pjesë në Analizë

1. Prishtinë
2. Prizren
3. Gjakovë
4. Pejë
5. Mitrovicë
6. Gjilan
7. Ferizaj
8. Podujevë
9. Rahovec
10. Suharekë
11. Kamenicë
12. Kaçanik
13. Skenderaj
14. Deçan
15. Drenas
16. Malishevë
17. Klinë
18. Istog
19. Fushë Kosovë
20. Viti
21. Shtime
22. Lipjan
23. Dragash
24. Hani i Elezit
25. Junik
26. Shtërpce
27. Partesh
28. Ranillug

Lista e OJQ-ve që kanë marrë pjesë në Analizë

1. Handikos Gjakovë
2. Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror - OFAP
3. Qendra Labyrinth
4. SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë
5. Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve Kosovë

SHTOJCA 2

Dokumentet e shqyrtuara

Koncept dokumenti për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare, Shkurt 2019

Analiza e Nevojave për Kapacitetet e Qendrave për Punë Sociale në Kosovë në Fushën e Promovimit dhe Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Handikos, Tetor 2020

Analizë e situatës, Save the Children 2018

Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve sociale në Kosovë, Save the Children

Raport Monitorimi mbi Procesin e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale – Shërbime Sociale, Afër Qytetarit, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF 2022

Analizë e Situatës - Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë, Save the Children Kosova/o, Mars 2018

Hulumtimi Lokal mbi Mbikëqyrjen e Punëtorëve Socialë dhe Punëtorëve të tjerë të Kujdesit që punojnë në ekipet e integruara dhe multidisiplinare në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit të Kujdesit Social për Fëmijë (CASCADE), Prill 2022

Regional Research on Violence Against Children in Schools in South Eastern Europe, Child Protection Hub, December 2020

Baseline Study - Strengthening Social Service Provision for the most Vulnerable Groups in Kosovo in Response to Covid-19, Save the Children Kosova/o, March 2021

Evaluation Report - Final Project Evaluation of the Child Protection Hub for Southeast Europe, Junction Bulgaria, April 2022

Social Services in Municipalities, Financing Trends 2010 – 2023, Kosovo Local Government Institute, January 2023

Udhëzues për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Organit të Kujdestarisë në Qendrat Për Punë Sociale (QPS) të Republikës së Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes, Dhjetor 2022

Korniza ligjore e shqyrtuar:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës
- Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal –
- Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji nr/ 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
- Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik
- Rregullorja për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive
- Formula e Financimit për Shërbime Sociale

